



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /

Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /

Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate



VLERËSIMI I KËRCËNIMIT NGA KRIMET E RËNDA DHE KRIMI I ORGANIZUAR - SOCTA

2014-2015



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

SPCP 2012-16

Swiss Regional Police Cooperation Programme
in the Western Balkans


VLERËSIMI I KËRCËNIMIT NGA KRIMET
E RËNDA DHE KRIMI
I ORGANIZUAR - SOCTA

Prishtinë, Prill 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS	5
Lista e Shkurtesave	6
HYRJE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRIMINALITET - ANALIZA “PESTELO”	9
Faktorët Politik	9
Faktorët ekonomik / Social	10
Faktorët Teknologjik	12
Faktorët mjedisor	12
Faktorët Ligjor	13
Faktorët organizativ	14
AKTIVITETET KRIMINALE TË SHQYRTUARA SIPAS PRIORITETEVE TË CAKTUARA	14
TRAFIKIMI ME LËNDË NARKOTIKE	14
Problemi me përdorimin e lëndëve narkotike	17
Marihuana	19
Heroina	20
Kokaina	23
Ekstazia	24
TRAFIKIMI ME NJERËZ	24
Viktimat e Trafikimit	25
Faktorët që ndikojnë në trafikimin me njerëz	27
Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit në Kosovë	27
Metodat e rekrutimit në rastet e trafikimit me njerëz	28
Arrestimet e personave të përfshirë në trafikimin me njerëz	29
Mbrojtja e viktimave dhe Ri-integrimi	30
Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë	30
Raportimet nga Agjencitë dhe Organizatat Ndërkombëtare	31
Ndjekja dhe dënimi i rasteve të trafikimit me njerëz	31
EKSTREMIZMI DHE RADIKALIZMI	32
MIGRIMI ILEGAL	35
KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE	38

<u>Rrugët e kontrabandimit të migrantëve</u>	<u>40</u>
<u>Rruga e parë – Kosovë - Serbi - Vojvodinë - Hungari</u>	<u>40</u>
<u>Rruga e dytë – Kosovë - Mali i Zi - Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci - Hungari</u>	<u>41</u>
<u>Rruga e tretë – Kosovë - Maqedoni – Greqi - Itali</u>	<u>41</u>
<u>Mediat dhe roli i tyre</u>	<u>41</u>
<u>KONTRABANDIMI ME MALLRA</u>	<u>42</u>
<u>Kontrabandimi me Mallra 2012- 2015 – rastet e iniciuara nga policia</u>	<u>43</u>
<u>Kontrabandimi i Mallrave sipas rajoneve kufitare, bazuar në informacionet e bazës së të dhënave nga SIPK-u</u>	<u>43</u>
<u>Kufiri Kosovë – Shqipëri</u>	<u>43</u>
<u>Kufiri Kosovë - Maqedoni</u>	<u>43</u>
<u>Kufiri Kosovë – Serbi</u>	<u>44</u>
<u>Bashkëpunimi ndër institucional</u>	<u>44</u>
<u>Kontrabanda me karburante dhe derivate të naftës</u>	<u>45</u>
<u>Kontrabanda me medikamente</u>	<u>46</u>
<u>Kontrabanda me Cigare dhe Duhan të papërpunuar</u>	<u>47</u>
<u>Kontrabanda e produkteve ushqimore (konsumit të përgjithshëm)</u>	<u>48</u>
<u>Mallrat të cilat shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale</u>	<u>48</u>
<u>Ndikimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim – MSA</u>	<u>49</u>
<u>KRIMET KIBERNETIKE</u>	<u>49</u>
<u>Rastet e krimit kibernetik / Trendet</u>	<u>50</u>
<u>Infrastruktura ligjore</u>	<u>51</u>
<u>Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike</u>	<u>52</u>
<u>Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2015 – 2018</u>	<u>52</u>
<u>Parandalimi dhe luftimi i krimit kibernetik në Kosovë</u>	<u>52</u>
<u>KORRUPSIONI/ SHPËRLARJA E PARAVE</u>	<u>53</u>
<u>Tabela 14 – Veprat penale të korrupsionit periudha kohore 2012-2015</u>	<u>54</u>
<u>KRIMINALITETI I PËRGJITHSHËM</u>	<u>57</u>
<u>ARMËT ILEGALE</u>	<u>57</u>
<u>VRASJET</u>	<u>58</u>
<u>FAJDET /DETYRIMET</u>	<u>58</u>
<u>GRABITJET</u>	<u>60</u>



Z. Shpend MAXHUNI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS

Është kënaqësi e madhe të prezantojmë Vlerësimin e dytë të Kërcënimit nga Krimet e Renda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA) të hartuar nga Policia e Kosovës. SOCTA, paraqet vlerësimin e kërcënimit të trendeve aktuale dhe atyre të reja të pritura të krimit serioz dhe krimit të organizuar brenda shtetit tonë. Vlerësimi bazohet mbi njohuritë ekzistuese dhe ekspertizën dhe është bërë në mënyrë që t'u mundësojë vendimmarrësve të ndërmarrin veprimet e duhura, për të iu kundërvënë kërcënimeve të parashikuara.

Të gjitha agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit kanë ofruar kontribut të vlefshëm siç kanë bërë edhe institucionet e tjera në nivel kombëtar.

Jam mirënjohës dhe e falënderoj Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe Qeverinë Zvicërane, DCAF-in për përkrahjen e vazhdueshme gjatë hartimit të këtij dokumenti.

Në fund, stafi i Policisë së Kosovës në përgjithësi dhe i Analistëve të PK-së në

veçanti meritojnë mirënjohje për punën dhe përpjekjet e tyre për të përgatitur këtë dokument.

SOCTA do të jetë një hap i rëndësishëm për të ngritur nivelin e bashkëpunimit në mes të autoriteteve të ndryshme kompetente brenda vendit. Kjo do të kontribuojë në zhvillim të mëtutjeshëm të synimeve të përbashkëta në parandalimin dhe luftimin e krimit serioz dhe krimit të organizuar. Duke ju referuar raportit të SOCTA-s, do të investohet në potencialin tonë që të profesionalizohemi në vazhdimësi, duke synuar të arriturat maksimale, për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurtë, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Z. Shpend MAXHUNI

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Data: 01.04.2016

Nënshkrimi: _____

Lista e Shkurtesave

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
BE	Bashkimi Evropian
DCAF	Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura
DK	Dogana e Kosovës
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
EUROSTAT	Enti Statistikor i Bashkimit Evropian
EUROPOL	Organizata Policore Evropiane
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Menaxhimin dhe Bashkëpunim në Kufijtë Jashtëm
INTERPOL	Organizata Policore Ndërkombëtare
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe zhvillime të Politikave
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSA	Marrëveshje së Stabilizim Asocimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OJQ	Organizata jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombëve të Bashkuara
PK	Policia e Kosovës
QKUK	Qendra Klinik Universitare e Kosovës
SOCTA	Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit Serioz dhe Krimit të Organizuar
SELEC	Qendra juglindore evropiane për zbatimin e ligjit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
STIKK	Shoqata Kosovare për Teknologji Informacion dhe Komunikim
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkoshëm i Kombëve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime

HYRJE

Policia e Kosovës, duke marrë parasysh trendet dhe kërcënimet nga format e krimit të organizuara dhe ato të rënda, ka identifikuar nevojën që të hartohet një dokument strategjik për vlerësimin e trendeve aktuale dhe parashikimin e vlerësimit në të ardhmen nga këto forma të kriminalitetit (SOCTA).

Dokumenti SOCTA përmban vlerësime të detajuara lidhur me format më të theksuara të krimit të organizuar dhe atyre serioze, kërcënimet që paraqesin këto forma të kriminalitetit, duke potencuar kërcënimet e përgjithshme të sigurisë, ekonomisë, shoqërisë por edhe individëve në veçanti, si dhe sfidat dhe vështirësitë e identifikuar për të cilat janë dhënë rekomandime konkrete për zvogëlimin apo eliminimin në tërësi të tyre. Dokumenti SOCTA do të hartohet në dy versione, atë të mbyllur që do të jetë në dispozicion të Institucioneve të vendit, veçmas atyre të sigurisë dhe në atë të hapur që do të jetë i publikuar në ueb faqen e Policisë së Kosovës dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ky vlerësim përfshin periudhën kohore dy vjeçare (2014 – 2015) duke krahasuar të dhënat dhe trendet e kriminalitetit me periudhën paraprake dy vjeçare (2012 – 2013), duke synuar që të jemi në hap me dokumentin SOCTA të EUROPOL-it, i cili hartohet në baza katër vjeçare (dokumenti i ardhshëm pritet të publikohet gjatë vitit 2017 apo në fillim të vitit 2018).

Hartimi dhe publikimi i këtij vlerësimi do të pasohet me hartimin dhe publikimin e përbashkët të dokumentit SOCTA në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, që ka për synim identifikimin e kërcënimeve të përbashkëta nga format e krimit të organizuar dhe grupet e organizuara kriminale, si dhe planifikimin e përbashkët për të u ballafaquar me këto kërcënime.

Të dhënat e siguruara për hartimin e këtij dokumenti janë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të dhënat zyrtare nga Policia e Kosovës, të dhënat nga institucionet tjera relevante, agjencive të pavarura dhe atyre të specializuara, OJQ të ndryshme, të dhëna nga sektori privat por edhe të dhëna nga burimet e hapura, duke përfshirë edhe hulumtime të ndryshme nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Të gjitha të dhënat e siguruara u janë nënshtruar procesit të inteligjencës, përkatësisht vlerësimit, krahasimit dhe analizimit të detajuar të tyre.

Gjatë hartimit të SOCTA janë shfaqur edhe disa sfida dhe vështirësi, kryesisht në kualitetin e të dhënave që ishin në dispozicion. Disa të dhëna të nevojshme për hartimin e këtij dokumenti nuk janë arritur të sigurohen, si pasojë e mos posedimit të tyre apo për shkak të vështirësive gjatë krahasimit të të dhënave të ruajtura në formate të ndryshme. Shumica e këtyre vështirësive janë identifikuar dhe janë potencuar në përmbajtjen e dokumentit, qoftë gjatë vlerësimit apo edhe në rekomandimet të cilat janë bashkangjitur si pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Të gjeturave në këtë dokument dhe rekomandimet e dala si rezultat i vlerësimit të bazuar në analizë të hollësishme, do të implementohen përmes strategjisë së kontrollit e cila do të

hartohet pas publikimit të këtij dokumenti, pjesë e së cilës do të jenë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të sigurisë në vend dhe agjencive tjera të specializuara.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Grupet e organizuara kriminale që shtrijnë aktivitetin e tyre në Kosovë vlerësohet të jenë mjaft komplekse dhe mirë të organizuara, duke u degëzuar në grupe më të vogla, por mjaft efektive në arritjen e qëllimeve të tyre.

Trendi i trafikimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike mbetet mjaft shqetësues, edhe pse si rezultat i zhvillimeve në nivel global dhe reduktimit të ofertës vërehet një ulje e konsiderueshme e sasisë së lëndës narkotike e cila hyn në Kosovë apo kalon përmes Kosovës me qëllim të trafikimit të saj në vendet e BE-së. Megjithatë, shqetësues mbetet numri i përdoruesve të lëndëve narkotike, duke përfshirë edhe drogat e forta, siç janë Heroina dhe Kokaina. Këto lloj drogash duke marrë parasysh diferencën në mes të ofertës dhe kërkesës, shpesh herë në tregun vendor gjendet e përzier me prekursorë dhe substanca tjera të rrezikshme të cilat rrezikojnë shëndetin por edhe jetën e përdoruesve të lëndëve narkotike.

Trafikimi me Njerëz mbetet një trend tjetër të cilit duhet ti kushtohet vëmendje. Viteve të fundit ka një progres në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Edhe përkundër këtij progresi kjo akoma mbetet sfide të cilës duhet kushtuar kujdes sidomos duke u fokusuar në trafikimin e brendshëm të viktimave të trafikimit. Kjo vepër zakonisht kryhet duke përdorur metoda të ndryshme të detyrimit të viktimave, me theks të veçantë kërcënimet dhe shantazhet që iu nënshtrohen viktimat e trafikimit, të cilat kryesisht detyrohen të ofrojnë shërbime seksuale. Element shqetësues është trendi në rritje i viktimave të trafikimit të moshave të reja, duke përfshirë edhe të moshën e mitur (nën moshën 18 vjeçare).

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm viteve të fundit vazhdon të jetë një ndër sfidat kryesore të Republikës së Kosovës. Edhe pse deri më tani nuk është shënuar ndonjë rast i ndonjë sulmi apo tentim sulmi brenda territorit të Republikës së Kosovës, megjithatë shqetësuese mbetet pjesëmarrja e një numri të caktuar, në krahasim me vendet e tjera të rajonit të qytetarëve të saj në konflikte jashtë vendit, posaçërisht në radhët e grupeve terroriste, por edhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të disa prej tyre në akte terroriste.

Kontrabandimi me Migrant si rezultat i gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale me të cilën ballafaqohet Republika e Kosovës, gatishmëria dhe vullneti qytetarëve të saj për të migruar në drejtim të vendeve perëndimore, kryesisht atyre të BE-së mbetet mjaft i lartë dhe në pamundësi që të migrojnë në mënyrë të rregullt, ata bienin për e grupeve të organizuara kriminale, të cilat duke përfitur nga situata përfitojnë shuma të mëdha parash duke kontrabanduar qytetarë nga Kosova në drejtim të vendeve perëndimore.

Kontrabanda me mallra vazhdon të paraqet ndër kërcënimet kryesore për Kosovën dhe qytetarët e saj. Kontrabanda me mallra kryesisht është e bazuar në mallrat që iu nënshtrohen vlerës së lartë të akcizës dhe taksave doganore. Megjithatë mjaft evidente është edhe kontrabandimi i produkteve ushqimore, veçanërisht produkteve të mishit dhe produkteve

medicinale, të cilat rrezikojnë seriozisht shëndetin dhe jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Krimet kompjuterike janë ndër fenomenet në rritje viteve të fundit, të cilat kryesisht janë të shfaqura për qëllime të përfitimit, përkatësisht vjedhjes dhe mashtrimit përmes kartelave bankare, megjithatë janë shfaqur edhe disa raste të keqpërdorimit të fëmijëve, përkatësisht pornografia e fëmijëve në internet dhe hyrjet e paautorizuara në sistemet kompjuterike. Përdorimi i internetit është mjaft i lartë për qëllime të propagandës nga individ apo grupe ekstremiste, të cilat kryesisht përmes rrjeteve sociale identifikojnë dhe rekrutojnë anëtarë të rijë, me fokus personat në moshë të re.

Korrupsioni dhe shpërlarja e parasë janë ndër fenomenet më të përfolura të cilat zgjojnë interesimin jo vetëm të institucioneve të Kosovës, por edhe shoqërisë në përgjithësi. Këto fenomene vazhdojnë të mbesin subjekt i hulumtimeve të ndryshme nga organizata vendore dhe ndërkombëtare. Derisa korrupsioni sipas vlerësimeve vazhdon të jetë më i përhapur në fushën e prokurimit publik, shëndetësisë, privatizimit etj, shpërlarja e parasë që burojnë nga aktivitete kriminale kryesisht është e fokusuar në investime në prona të paluajtshme, hoteleri etj.

Krimet e rënda siç janë vrasjet, viteve të fundit kanë shënuar një rënie të dukshme, duke përfshirë edhe vrasjet nga apo për interes të grupeve të organizuara kriminale, megjithatë ndër format e kriminalitetit që mbetet mjaft evidente dhe që nuk raportohen sa duhet janë rastet e fajdes dhe detyrimit.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRIMINALITET - ANALIZA “PESTELO”

Analiza PESTELO është akronim për një model makro-analitik që analizon faktorët nga fusha Politike, Ekonomike, Sociale, Teknologjike, Mjedisore, Ligjore dhe Organizative, që të përcaktojmë ndikimin e tyre në trendet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Faktorët Politik

Republika e Kosovës vazhdon të përballet me tensione politike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë tek efikasiteti i institucioneve të sigurisë në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

Ngërçi politik që është karakterizuar gjatë vitit 2014, si pasojë e vonesave në krijimin e institucioneve ka lënë pasojë në hartimin dhe miratimin e disa ligjeve të rëndësishme, por edhe në emërimin e anëtarëve të bordeve në shumë institucione dhe kompani publike. Kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe tek shoqëria kosovare, duke lëkundur besimin e tyre në institucionet e vendit.

Ndër pasojat e drejtpërdrejta nga kjo situatë ishte edhe vonesa e miratimit të ligjit për ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte jashtë vendit, gjë që ndikoi në efikasitetin e institucioneve të sigurisë për të parandaluar qytetarët e Kosovës për të udhëtuar në zonën e konfliktit në lindjen e mesme. Ky ligj ishte ndër ligjet e para që janë miratuar pas konstituimit të institucioneve të vendit, duke iu mundësuar institucioneve të sigurisë që përveç sanksionimit të pjesëmarrjes aktive në konflikte jashtë vendit, të sanksionohet edhe propaganda dhe thirrjet për pjesëmarrje në konflikte jashtë vendit.

Kjo situatë është shfrytëzuar maksimalisht nga individ dhe grupe të caktuara, të cilët duke përfituar nga mos funksionimi i disa prej institucioneve kyçe të vendit, duke përfshirë edhe kuvendin, por edhe duke marrë parasysh fushatën mediatike në përshkrimin e situatës, ka krijuar kushte të favorshme për aktivitetin e tyre kriminal, veçanërisht në kontrabandën me migrant. Kjo ka ardhur fillimisht si pasojë e situatës së rëndë ekonomike dhe sociale në njërin anë, mirëpo edhe si pasojë e humbjes së besimit të qytetarëve nga ana tjetër në institucionet e vendit, apo edhe duke humbur shpresën që kjo situatë mund të ndryshojë.

Institucionet e vendit të formuara pas rreth gjashtë muaj bllokade, që nga konstituimi i tyre janë përballur me sfida të reja, si rezultat i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë dhe arritjes së disa marrëveshjeve për çështje të caktuara, të cilat marrëveshje janë kundërshtuar ashpër nga opozita, duke i vlerësuar si marrëveshje shumë të dëmshme për vendin. Këto kundërshtime të opozitës të mbështetura edhe nga një numër i qytetarëve, kanë bllokuar pothuajse në tërësi apo vështirësuar në masë të madhe jetën parlamentare në vend, që si pasojë ka patur eskalim të situatës dhe dëmtime të pronës publike dhe asaj private.

Kjo situatë përveç që ka ndikuar në zhvendosjen e fokusit të institucioneve të vendit nga çështje që janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, si dhe forcimin e sundimit të ligjit në tërë territorin e vendit, në të njëjtën kohë ka ndikuar edhe tek ndjenja e sigurisë tek qytetarët e Kosovës, të cilët ndihen mjaft të brengosur për sigurinë e tyre dhe të pronës së tyre.

Si pasojë e këtyre kundërshtimeve dhe organizimit të protestave të dhunshme, institucionet e sigurisë në vend, posaçërisht Policinë e Kosovës janë detyruar që të shpenzojnë kohë dhe të jenë të fokusuar më shumë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë, si dhe në mbrojtjen e pronës publike dhe asaj private. Kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitetin e institucioneve të vendit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, por edhe ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit, veçanërisht pas zhvillimeve në nivel global pas sulmeve terroriste në disa vende të ndryshme, dhe ngritjes së shqetësimeve për sulme të ngjashme që mund të përsëriten edhe në vende tjera, duke mos përjashtuar edhe Kosovën.

Faktorët ekonomik / Social

Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik e përcjellë me nivelin e lartë të papunësisë dhe një numër të lartë të punë kërkuësve që arrin shifrën prej rreth 30% të personave të aftë për punë, mund

të ndikojë drejtpërdrejtë në situatën e sigurisë në vend, por edhe të zhvillimit të krimit të organizuar.

Kjo gjendje e rëndë ekonomike e shumicës së qytetarëve të vendit mund të ndikojë që disa persona të fillojnë të merren me aktivitete kriminale për të përfituar para në mënyrë të shpejtë. Kjo nuk do të thotë që të gjithë të papunët kyçen në aktivitete kriminale por kjo situatë shfrytëzohet nga grupet kriminale për të rekrutuar anëtarë të rinj në aktivitetet kriminale duke i joshur me premtime se do të bëhen të pasur për një kohë të shkurtë.

Grupet kriminale gjenden e rëndë ekonomike të qytetarëve të vendit (kryesisht të moshave të reja të papunëve dhe me nivel të ultë të arsimit) e shfrytëzojnë duke i inkuadruar në aktivitete kriminale si kurier të lëndëve narkotike, trafikim me qenie njerëzore –prostitution ,lëmosh kërkues dhe vepra tjera.

Një veprimtari mjaft fitimprurëse për grupet kriminale është edhe falsifikimi i markave (brendeve) të regjistruara. Falsifikimi bëhet kryesisht në sektorin e industrisë së tekstilit (veshmbathjeve), pasi që në mungesë të të ardhurave është ngritur edhe kërkesa për produkte të tilla. Këto produkte disa vijnë si produkte finale të cilat kontrabandohen, e disa të tjera prodhohen në Kosovë, por për mungesë të ekspertëve dhe laboratorëve për ekspertiza këto produkte mbeten të paidentifikuar si të falsifikuara .

Gjendja ekonomike në Republikën e Kosovës është e ndërlidhur direkt edhe me gjendjen sociale. Kosova llogaritet në mesin e vendeve me një zhvillim të ulët ekonomik ku një numër jo i vogël i qytetarëve jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, kjo gjendje është e karakterizuar me numër të madh të papunëve, me mungesë të ligjit për sigurime shëndetësore, të ardhura sociale minimale, çmime të larta dhe shërbimeve publike, pagat e ulëta sidomos në sektorin privat, kualiteti i arsimit në nivelin jo të kënaqshëm dhe jo drejtuar sipas kërkesave të tregut të punës etj.

Mungesa e sigurimeve shëndetësore detyron qytetarët që të furnizohen me medikamente dhe të kërkojnë një shërbim më të mire mjekësor duke u detyruar që këto shërbime t'i kërkojnë në institucionet private që janë mjaft të shtrenjta apo të drejtohen në institucionet publike, por duke dhënë rryshfet, në mënyrë indirekte stimulojnë korrupsionin.

Shkalla e arsimit mund të merret si faktorë lehtësues për zhvillimin e krimit të organizuar nga fakti që tek niveli i mesëm , i ultë dhe atyre gjysmë analfabet niveli i njohurive për dëmet që shkaktohen nga aktiviteti i krimit të organizuar është mjaft i ulët, për të mos thënë që nuk kanë njohuri fare.

Kjo gjendje sociale ekonomike është shfrytëzuar nga grupet kriminale të cilat kanë organizuar një valë të madhe të migrimit në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, duke ju premtuar viktimave që ne shtetet e bashkimit evropian po pranohen kërkesat për azil të qytetarëve të Kosovës.

Faktorët Teknologjik

Zhvillimi i hovshëm teknologjisë informative ka ndikuar edhe në paraqitjen e veprave të reja penale të ashtuquajtura krimet kibernetike të cilat kanë marrë hov viteve të fundit.

Sipas vlerësimeve nga institucionet e vendit por edhe nga organizata joqeveritare, përdorimi i internetit në Kosovë është në shkallë mjaft të lartë që sipas disa të dhënave statistikore kjo shifër mund të arrijë mbi 80%. Megjithatë edhe përkundër këtij niveli të lartë të përdorimit të internetit, Kosova edhe më tutje nuk ka në dispozicion kod apo provider të vetin për shërbime të internetit, duke u bazuar në shërbimet nga vendet tjera, siç janë Shqipëria dhe Serbia. Andaj edhe Institucionet e vendit ballafaqohen me sfida sa i përket sigurisë së rrjeteve dhe informacionit. Kjo ndikon drejtpërdrejtë edhe me mundësitë apo kapacitetet e limituara për përgjimin e telefonave të operatorëve të huaj të cilët operojnë në Kosovë.

Krahas shfrytëzimit të shërbimeve të internetit dhe teknologjisë nga qytetarët e Kosovës, të njëjtat përdoren mjaft shumë edhe nga individ apo edhe grupe të organizuara kriminale, aktiviteti i të cilave ka filluar të jetë i varur shumë nga teknologjia informative. Këta individ apo grupe të organizuara kriminale përdorin shërbimet e internetit edhe për komunikim dhe organizim të aktivitetit të tyre, që e bën mjaft të vështirë për institucionet e vendit, posaçërisht atyre të sigurisë që të zbulojnë aktivitetet e tyre kriminale.

Rrjetet sociale në internet shfrytëzohen nga grupet kriminale edhe për propagandimin e ideologjive që ndërlidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin për rekrutimin e pjesëtarëve të rinj.

Ndërhyrja në sistemet kompjuterike bankare duke kryer transaksione të kundërligjshme për përfitime personale, ndërhyrje në të dhënat personale dhe faqe zyrtare të cilat shpesh herë përveç që cenojnë të drejtat themelore të njeriut këto ndërhyrje mund të paraqesin edhe kërcënim për institucionet e sigurisë. Pastaj nga ndërhyrjet në sistemet e institucioneve të sigurisë mund të zbulohet të dhëna sekrete që paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare. Në luftimin e krimeve kibernetike Policia e Kosovës ka nevojë për ngritjen kapaciteteve si me pajisje të teknologjisë së fundit, ashtu edhe me personel të trajnuar për të detektuar dhe hetuar krimet kibernetike.

Faktorët mjedisor

Pozita gjeografike e Kosovës është një faktor që në mënyra të ndryshme paraqet terren të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kriminale dhe krimet të organizuar. Ndonëse nuk është vendi kyç që lidh vendet e lindjes dhe perëndimit Kosova gjendet në një pikë mjaft strategjike të Ballkanit Perëndimor ku shpesh herë shfrytëzohet nga grupet kriminale .

Klima e cila mbretëron në Kosovë është duke u shfrytëzuar nga individë apo grupe kriminale për kultivimin e lëndës narkotike Cannabis Sativa, ndonëse deri më tani nuk ka ndonjë të dhënë për kualitetin e lëndës narkotike që prodhohet nga bimët që kultivohen në Kosovë.

Vija kufitare e Republikës së Kosovës me shtetet fqinje shtrihet kryesisht në teren të thyeshëm malor dhe në shumë pjesë i pakalueshëm për mjetet motorike, që paraqet teren të përshtatshëm për kalime ilegale të kufijve nga individë apo grupe kriminale.

Sa i përket mjedisit jetësor në Republikën e Kosovës gjendja aktuale paraqitet mjaft shqetësuese pasi që në vazhdimësi po bëhet një degradim në të gjitha resurset natyrore, si degradimi i shtretërve të lumenjve nga nxjerrja ilegale e zhavorrit, si dhe prerja ilegale dhe shkatërrimi i pyjeve.

Faktorët Ligjor

Vendi ynë që nga shpallja e pavarësisë në vazhdimësi është duke bërë përpjekje që të miratojë dhe të plotësojë legjislacionin me ligje në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligjet e miratuara janë në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian e që është një parakusht për secilin vend që synon që t'i bashkohet këtij Unioni. Megjithëse Kosova ka një infrastrukturë ligjore të mirë edhe më tutje mbetet sfiduese për organet e zbatimit të ligjit implementimi i disa ligjeve .

Kohëve të fundit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka arritur që ta miratojë ligjin për parandalimin e pjesëmarrjes në luftëra të huaja. Ky ligj ishte i domosdoshëm për arsye se një numër i qytetarëve të Republikës së Kosovës ju kanë bashkangjitur grupeve terroriste në Siri dhe Irak. Miratimi i këtij ligji do të ndikoj pozitivisht në parandalimin e atyre individëve të cilët kanë për qëllim që të shkojnë jashtë vendit për të luftuar në vendet e huaja.

Nje nga mekanizmat për luftimin e Krimit të Organizuar dhe për ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës është edhe rishikimi i ligjit për konfiskimin e pasurisë të përfituar nga vepra penale. Me këtë ligj subjekti do të obligohej që të dëshmoj prejardhjen e pasurisë (ligji i ashtuquajtur anti mafia), dhe ky ligj është i aplikueshëm në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian por edhe në disa shtete të cilat synojnë të jenë pjesë e Unionit. Përmes këtij ligji do të kontrollohej më lehtë prejardhja e pasurisë së personave të dyshuar.

Në luftimin e veprave penale nga krimi i organizuar e në veçanti trafikimi me lëndë narkotike është i domosdoshëm rishikimi dhe amandamentimi i ligjit për substancat narkotike, psikotropike dhe prekursorëve pasi që një numër i prekursorëve që mund të përdoren për prodhimin e substancave narkotike me ligjin në fuqi nuk janë të parapara si substanca të ndaluara.

Aprovimi i ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit është i mirëpritur pasi që do të kompensojë dhe do të ndikojë pozitivisht që viktimat e krimit të rehabilitohen. Gjithashtu, ligji i miratuar për përgjimet ka rëndësi të madhe për Institucionet e sigurisë në luftimin e kriminalitetit të përgjithshëm dhe krimit të organizuar duke marrë parasysh se zhvillimin e

hovshëm të teknologjisë informative e shfrytëzojnë edhe grupet e organizuara kriminale dhe personat të cilët merren me aktivitete kriminale.

Faktorët organizativ

Kosova është në fazën e konsolidimit të institucioneve të sigurisë dhe synon ngritjen e kapaciteteve të plota për kryerjen e detyrave dhe obligimeve të caktuara me ligjet në fuqi. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike të institucioneve të sigurisë është detyrë parësore e menaxhmentit dhe Qeverisë së Kosovës, të cilat institucione në vazhdimësi janë duke bërë përpjekje që të arrihet ky qëllim.

Sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional Policia e Kosovës bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe me institucionet e sigurisë në shtetet fqinje dhe më gjerë. Por për arsye politike Policia e Kosovës ende nuk ka arrite që të pranohet në organizata policore si Interpol dhe Europol të cilat janë institucione shumë të rëndësishme ndërkombëtare.

AKTIVITETET KRIMINALE TË SHQYRTUARA SIPAS PRIORITETEVE TË CAKTUARA

TRAFIKIMI ME LËNDË NARKOTIKE

Trafikimi me lëndë narkotike vazhdon të mbetet ndër format më të theksuara të përfshirjes së grupeve të organizuara kriminale në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimeve nga agjencionet dhe organizatat ndërkombëtare që merren me vlerësimin nga krimi i organizuar në përgjithësi dhe trafikimit me lëndë narkotike në veçanti (**UNODC, SELEC, EUROPOL** etj) është llogaritur që Kosova gjendet në njërin ndër rrugët më të rëndësishme të trafikut ndërkombëtar të substancave narkotike të llojit heroinë, por edhe në njërin ndër rrugët e trafikut ndërkombëtar të substancave tjera si mariuhana e kokaina.

Këto vlerësime nuk janë të bazuara në të dhëna zyrtare të Institucioneve të Kosovës, por janë siguruar në forma të ndryshme, duke përfshirë raportimet e vendeve fqinje apo edhe raportimet individuale nga zyrtarë të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Kjo mund të mbështetet edhe nga të dhënat zyrtare mbi konfiskimin e lëndëve narkotike përgjatë kufijve dhe në brendësi të territorit të Kosovës, konfiskime të cilat me përjashtim të Mariuhanës, kanë qenë kryesisht në sasi relativisht të vogla, duke mos kaluar sasinë më tepër se 10 kg për një dërgesë.

Mirëpo duke marrë parasysh pozitën gjeografike, Kosova nuk është vendi me rëndësinë me të madhe në të ashtuquajturën rrugë ballkanike të trafikimit të drogës, pasi që nuk është vendi i parë, por as edhe i fundit që ndërlidh rrugët e trafikut mes ofertës dhe kërkesës, përkatësisht Azinë apo lindjen e mesme me vendet e Evropës Perëndimore. Sasia e lëndës narkotike që është destinuar të kalojë përmes Kosovës për në Evropën Perëndimore, kryesisht është në sasi më të vogla, ndërsa transporti i saj kryesisht bëhet me vetura private, duke shfrytëzuar diasporën Kosovare në vendet e Evropës Perëndimore, të cilët vizitojnë shpesh Kosovën. Megjithatë duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të Kosovës për prodhimin e mallrave me qëllim të eksportit, mungesën e kompanive për transportimin e mallrave, apo edhe vështirësitë që kanë qytetarët e Kosovës për të lëvizur lirshëm për në vendet e BE-së, Kosova gjithnjë e më pak shihet si një vend atraktiv me qëllim të trafikimit të lëndëve narkotike përmes territorit të saj.

Për dallim nga trendi aktual, veçanërisht në vendet e BE-së dhe më gjerë në trafikimin e lëndëve narkotike, në Kosovë deri më tani nuk është shënuar ndonjë rast i trafikimit përmes dërgesave postare, kjo më shumë si rezultat i procedurave mjaft strikte doganore të cilat aplikon Kosova lidhur me kontrollin e mallrave ë cilat hyjnë në territorin e saj. Gjithashtu deri më tani nuk është identifikuar ndonjë rast i trafikimit të lëndëve narkotike përmes internetit.

Bazuar në të dhënat zyrtare të Institucioneve të sigurisë në Kosovë viteve të fundit është shënuar një rënie e sasisë së lëndëve narkotike, posaçërisht të heroinës, ndërsa që nga viti 2014 vërehet rënie edhe në sasinë e mariuhanës, e cila ndërlidhet me operacionet e fundit të ndërmarra nga autoritetet Shqiptare për asgjësimin e parcelave (sipërfaqeve, tokave) në të cilat kultivohej kanabisi. Gjatë vitit 2014 në krahasim me vitet paraprake është shënuar rritje e konsiderueshme e konfiskimit të lëndës narkotike të llojit kokainë, por e cila nuk mund të merret si indikator i prezencës më të madhe të kësaj lënde narkotike në tregun kriminal, pasi që pothuajse e tërë sasia e konfiskuar është bërë gjatë një operacioni të përbashkët me autoritetet Shqiptare.

Lloji i drogës	2012	2013	2014	2015
Marihuana	1238kg	581kg	738kg	462kg
Heroina	94.1kg	22.4 kg	9.6 kg	9.6kg
Kokaina	7.4kg	3.3 kg	21.1 kg	0.054 kg
Ekstazy	153	107	52	265
Bimë Kanabis	10584	1512	6930	2557
Fara Kanabisi	12508	1024	5165	141

Tabela 1. Konfiskimet nga Policia e Kosovës për gjatë viteve 2012 - 2015

Bazuar në trendët në nivel global dhe rajonal të prezencës së llojeve të drogave të ndryshme sintetike, ekziston dyshimi që këto lloje të drogave të jenë prezentë edhe në tregun kriminal të Kosovës, megjithatë bazuar në të dhënat e Institucioneve të sigurisë dhe institucioneve shëndetësore, duke përfshirë edhe Organizatat Jo qeveritare edhe më tutje vazhdojnë të dominojnë drogat e zakonshme si Heroina, Kokaina, Mariuhana, Extasy.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës mbi konfiskimin e lëndëve narkotike, që nga viti 2012 (shih tabelën 1) edhe pse në bazë të burimeve të hapura dhe burimeve të inteligjencës ka informacione për prezencën edhe të disa llojeve të drogave sintetike, si Amfetaminë, LSD, JSB, GHB përveç llojeve të lëndëve narkotike të potencuar në tabelën në vijim nuk është regjistruar ndonjë rast i konfiskimit të këtyre llojeve të drogave apo edhe nuk është arritur të vërtetohet prezenca e këtyre llojeve të drogave në tregun kriminal të Kosovës.

Po ashtu edhe sipas të dhënave nga Organizata jo Qeveritare "Labyrinth" e cila merret me trajtimin e personave të varur nga lëndët narkotike, në të cilën qendër që nga viti 2002 janë trajtuar gjithsejtë 1084 persona, dominojnë përdoruesit e lëndëve narkotike mariuhanë, heroinë dhe kokainë dhe nuk është regjistruar ndonjë rast i trajtimit nga llojet e drogave sintetike.

Sipas të dhënave zyrtare nga njësitë hetimore, por edhe sipas të dhënave nga inteligjenca lëndët narkotike që janë prezentë në Kosovë, përveç destinimit për trafikimin e tyre në tregun e jashtëm, kryesisht në vendet e BE-së, një sasi e konsiderueshme e tyre janë të destinuara për tregun e brendshëm, edhe pse ka mungesë të të dhënave të sakta, mbi përqindjen apo sasinë e cila është e destinuar për treg të jashtëm apo të brendshëm.

Duke marrë parasysh raportet e punës apo edhe vlerësimin strategjik të drogave të hartuara nga Policia e Kosovës, përkatësisht nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Lëndë Narkotike, megjithëse përmbajnë të dhëna mbi sasinë e konfiskimit të lëndëve narkotike dhe personave të arrestuar, nuk është bërë ndonjë vlerësim apo analizë e detajuar mbi ndarjen e saktë të sasisë apo llojit të drogës të destinuar për tregun e jashtëm apo edhe asaj të destinuar për tregun e brendshëm. Gjithashtu është bërë ndarja e sasisë së drogave të konfiskuara sipas rajoneve, megjithatë duke marrë parasysh sasinë e të gjitha llojeve të drogave të konfiskuara gjatë vitit 2014 rezulton që në rajonin e Pejës ka pasur sasi me të madhe të lëndëve narkotike të konfiskuara, mirëpo bazuar në të dhënat nga OJQ Labyrinth mbi numrin e përdoruesve të cilët kanë kërkuar trajtim në këtë qendër gjatë vitit 2014 rreth 40% e tyre janë nga Rajoni i Gjilanit.

Vlerësuar në përgjithësi Kosova ka bazë të mjaftueshme ligjore për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me lëndë narkotike, duke tentuar që të përfshihen të gjitha Konventat e rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me narkotikët, duke përfshirë Kodin Penal, i cili me ndryshimet që janë bërë në vitin 2013 veprat penale që ndërlidhen me narkotikët i ka përfshirë në një kapitull të veçantë, duke ashpërsuar në të njëjtën kohë edhe sanksionet penale.

Ligj tjetër i rëndësishëm është Ligji mbi Barërat Narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, përmes të cilit ligj rregullohet çështja e përdorimit edhe të barërave narkotike, ku përveç pjesës përshkruese përmban edhe listën e barërave narkotike, prekursorëve dhe substancave psikotrope. Megjithatë duke marrë parasysh zhvillimet në nivel global dhe identifikimin e substancave të reja të cilat si të vetme nuk janë të përfshira në këto lista, mirëpo me përzierje me ndonjë substancë tjetër formojnë substanca të rrezikshme, është ngritur nevoja për ndryshime në këtë ligj, me theks të veçantë të azhurnimit të këtyre listave¹.

¹ Bazuar me bisedën që është zhvilluar më zyrtarët e laboratorit të forenzikës, në tregun Kosovar mund të gjenden substanca të shumta të cilat në rast të përzierjes me ndonjë substancë tjetër kimike mund të krijojnë substanca psikotrope mjaft të rrezikshme,

Përveç bazës ligjore Kosova në vitin 2012 ka hartuar strategjinë kombëtare kundër drogave dhe planin e veprimit 2012 - 2017, që synon të ndërtojë mekanizmin e nevojshëm për të qarë përpara luftën kundër drogave dhe ndikimin e tyre negativ nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Mirëpo, me gjithë angazhimin e deritanishëm në implementimin e aktiviteteve që dalin nga kjo strategji, akoma nuk është arritur që të realizohet themelimi i një bazë të të dhënave nacionale për evidentimin e personave të varur nga përdorimi i lëndëve narkotike. Po ashtu ka ngecje edhe në menaxhimin e metadonit, që përdoret për trajtimin e këtyre personave.

Institucionet e Kosovës vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të shumta sa i përket parandalimit dhe luftimit të trafikimit me lëndë narkotike, duke filluar nga nevoja e ndryshimit të ligjit mbi barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, pastaj mungesa e koordinimit të mirëfilltë të aktiviteteve ndër-institucionale. Vështirësitë më të mëdha hasen në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, pasi që Kosova përveç disa marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit me disa vende fqinje dhe më gjerë, nuk është e anëtarësuar në asnjë nga institucionet rajonale apo ndërkombëtare policore.

Problemi me përdorimin e lëndëve narkotike

Në Kosovë ka mungesë të një baze gjithëpërfshirëse të të dhënave mbi numrin e përdoruesve apo abuzuesve të lëndëve narkotike, mirëpo në bazë të disa të dhënave/informatave nga organizata të ndryshme jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare numri i përdoruesve apo abuzuesve të lëndëve narkotike sillet prej 15.000 - 30.000 apo shprehur në përqindje me numrin e përgjithshëm të popullatës në Kosovë 0.8% - 1.6%, prej të cilëve mes 5000 - 6000 apo shprehur në përqindje me numrin e përgjithshëm të popullatës në Kosovë 0.27% - 0.33% vlerësohet të jenë përdorues të drogave në mënyrë intravenoze.

Hezitimi i pranimit të trajtimit nga përdoruesit e drogës, përveç problemeve sociale mund të rrezikojë seriozisht edhe shëndetin e personave përdorues apo edhe të shkaktojë vdekjen si rezultat i mbidozës. Sipas të dhënave nga OJQ Labyrinth nga gjithsejtë 1084 persona që kanë pranuar trajtim në këtë qendër që nga viti 2002, 73 prej tyre kanë vdekur, edhe pse nuk dihet shkaktari i saktë i vdekjes, ndërsa sipas të dhënave nga Policia e Kosovës vetëm gjatë vitit 2014 janë shënuar 10 raste të vdekjes të dyshuara që janë si pasojë e mbidozës, për të cilat raste pritet konfirmimi nga Departamenti i mjekësisë Ligjore.

Edhe pse në mungesë të personelit dhe hapësirës së mjaftueshme, laboratorit në kuadër të Agjencionit të Forenzikës nuk realizon analiza të detajuara mbi përqindjen e përzierjes së drogave të cilat merren në mënyrë intravenoze me substanca tjera, megjithatë analizat e këtij laboratorit japin të dhëna mbi prezencën e substancave tjera, sidomos në atë sasi të destinuar për tregun e brendshëm, përkatësisht për përdorim, siç janë kafeinë, ibuprofen, acetaminofen, amfetaminë etj.

mirëpo të cilat për shkak se nuk janë paraparë në listën e Ligjit mbi Barërat Narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët nuk mund të ndiqen penalisht personat që gjenden në posedim të këtyre substancave.

Duke u bazuar në të dhënat nga OJQ Labyrinth dhe Departamenti i mjekësisë ligjore², përveç abuzimit me droga ekzistojnë raste të abuzimit edhe me barna të cilat bëjnë pjesë në grupin e barnave narkotike dhe të cilat nuk guxojnë të jepen pa përshkrim të mjekut, por një gjë e tillë nuk respektohet nga ana e farmacistëve, andaj edhe qasja tek këto barna, duke përfshirë edhe metadonin është mjaft e lehtë, që është edhe një ndër faktorët tjerë që ndikon në hezitimin e personave që të marrin trajtim në qendrat e specializuara për këtë qëllim.

Këto qendra përveç ofrimit të konsultimeve psikologjike për personat me varësi nga drogat, ofrojnë edhe trajtimin me metadon, substancë e cila gjendet edhe në tregun e zi, por edhe në farmaci, duke përfshirë edhe ato farmaci të cilat nuk janë të licencuara për shitjen e këtij produkti, ndërsa çmimi i tij është i përballueshëm nga shumica e personave në varësi të drogave. Në mungesë të qendrave të trajtimit në shumicën e qyteteve të Kosovës, për përdoruesit e lëndëve narkotike është më pak e kushtueshme që të blejnë metadonin në tregun e zi apo edhe në ndonjë farmaci, se sa të vizitojnë qendrat e specializuara për trajtim.

Kosova ballafaqohet me mungesë të institucioneve të mirëfillta për strehimin dhe trajtimin e personave të varur nga lëndët narkotike. Në Kosovë deri më tani janë 5 qendra të cilat merren me trajtimin dhe rehabilitimin e personave të varur nga substancat narkotike ato janë në: QKUK Prishtinë, Spitalet Rajonale Gjilan dhe Gjakovë, Burgu i Dubravës si dhe OJQ Labyrinth.

Bazuar në të dhënat nga Labyrinth mbi profilin e personave që janë në trajtim, moshë mesatare e personave të cilët për herë të parë kanë filluar përdorimin e lëndëve narkotike është rreth 18 vjeçare, andaj edhe pjesa më e madhe e këtyre personave janë të papunë, por edhe me nivel të ulët arsimor³, ndërsa edhe pse nuk ka të dhëna të sakta, besohet që një numër i konsiderueshëm i personave me varësi nga drogat, përfshihen në aktivitete të ndryshme kriminale me qëllim që të sigurojnë mjetet për sigurimin e lëndës narkotike për përdorim⁴.

Edhe pse nuk ekziston një studim i mirëfilltë i faktorëve që kanë ndikuar tek këta persona të fillojnë përdorimin e lëndëve narkotike, sipas të dhënave nga Labyrinth-i ekziston përshtypja që shumica e tyre kanë filluar përdorimin e lëndëve narkotike nga kureshtja apo edhe përfshirjes së tyre në shoqëri. Shqetësues mbetet fakti që shumica absolute e përdoruesve të lëndëve narkotike kanë filluar me marihuan apo hashash, mirëpo të cilët pastaj kanë përfunduar në droga tjera më të rënda, kryesisht në heroinë⁵.

² Gjatë diskutimeve që kemi patur me zyrtarët nga Departamenti për Mjekësi Ligjore janë identifikuar disa vështirësi në punën e tyre, të cilat ndërliiden për shkak të mungesës së aparaturave moderne për analiza toksilogjike, numër të personelit të kufizuar, si dhe hapësirës së pamjaftueshme. Laboratori për analiza toksilogjike me kapacitetet aktuale është në gjendje të bëjë vetëm 14 analiza dhe atë vetëm tek personat e vdekur, por jo edhe tek personat e gjallë.

³ Bazuar në të dhënat nga Labyrinth nga gjithsejtë 1084 persona të regjistruar si përdorues të lëndëve narkotike ë këtë qendër de të cilët janë apo kanë qenë në trajtim, 716 prej tyre nuk janë në marrëdhënie pune, ndërsa rreth 72 % e tyre kanë të mbaruar vetëm shkollimin e mesëm.

⁴ Bazuar në të dhënat nga Labyrinth nga gjithsejtë 1084 persona që kanë marrë trajtim në këtë qendër 529 prej tyre apo shprehur në përqindje 48.80 % kanë patur probleme me ligjin dhe kanë qenë të burgosur

⁵ Bazuar në të dhënat nga Labyrinth 798 persona nga gjithsejtë 1084 sa janë të regjistruar për trajtim kanë filluar me përdorimin e Mariuhanës, ndërsa 202 persona kanë filluar me përdorimin e drogës së parë me heroinë. Mirëpo me kalimin e kohës këto të dhëna kanë ndryshuar dhe tani janë të regjistruar vetëm 113 persona të cilët drogë primare kanë përdorimin e mariuhanës, ndërsa numri i përdoruesve ku si drogë të parë përdorin heroinën është ngritur në gjithsejtë 941.

Marihuana

Në sasinë më të madhe marihuana në Kosovë hyn nga Shqipëria, por në sasi më të vogla edhe nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi. Një pjesë e marihuanës ndalet në Kosovë për konsum të brendshëm ndërsa pjesa tjetër e cila konsiderohet disa herë më e madhe kalon transit drejt vendeve tjera, kryesisht drejt tregut të Evropës Perëndimore. Mariuhana hyn në Kosovë përmes rrugëve tokësore me mjete të ndryshme transporti përfshirë transportin e mallrave dhe të udhëtarëve përmes vendkalimeve kufitare por edhe përmes rrugëve ilegale marrë parasysht konfiguracionin e vijës kufitare.

Viteve të fundit Policia e Kosovës gjithnjë e më shumë është duke identifikuar sipërfaqe në të cilat kultivohet kanabis sativa. Në këto sipërfaqe të kultivuara ka rezultuar se lartësia e këtyre bimëve arrin deri në 2 metra çka tregon se edhe vendi ynë është i përshtatshëm për kultivimin e kësaj bime andaj gradualisht është duke u rritur edhe numri i kultivuesve të këtyre bimëve narkotike. Gjatë vitit 2014 janë hasur 19 raste të mbirjes së egër ose vetvetiu me gjithsej 3724 bimë kanabis sativa dhe 39 raste të kultivimit të kanabisit nga persona të dyshuar me gjithsej 3206 bimë.

Ndër rajonet ku janë regjistruar raste më të shumta të kultivimit të kanabisit janë rajoni i Mitrovicës dhe rajoni i Pejës dhe kryesisht në zona të thella rurale, ku identifikimi është mjaft i vështirë dhe në raste të caktuara mund të identifikohen vetëm në bazë të informacioneve paraprake për ekzistencën e këtyre plantacioneve.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura konfiskimet e mariuhanës dhe shkatërrimit të bimëve të kanabisit të cilat janë hasur në plantacione të ndryshme brenda territorit të Kosovës.

Lloji i drogës	2012	2013	2014	2015
Marijuana	1238kg	581 kg	738 kg	462 kg
Bimë Kanabisi	10.584	1512	6930	2557
Fara Canabis	12.508	1024	5165	141

Tabela 2- Konfiskimet e marihuanës, farave të kanabisit dhe shkatërrimi i bimëve të kanabisit në R. Kosovës në periudhën 2012- 2015

Në mungesë të analizave të detajuara nga laboratorit në kuadër të Agjencionit të Forenzikës, si pasojë e mungesës së personelit dhe hapësirës, ka qenë e pamundur që të determinohet saktë origjina e mariuhanës së konfiskuar, nëse ajo është kultivuar në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër apo është kultivuar brenda Kosovës.

Bazuar në trendin e konfiskimeve të mariuhanës vërehet një rënie e dukshme e sasisë së konfiskimit gjatë kësaj periudhe të vitit 2015, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me operacionet e ndërmarra nga Policia Shqiptare për asgjësimin e plantacioneve më kanabis në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Kjo ka ndikuar në uljen e ofertës në krahasim me kërkesën, që ka rezultuar edhe me rritjen e çmimit të mariuhanës në treg, ku një kilogram mariuhanë shitet rreth 600-900 euro, kurse një dozë prej 5 gram çmimi është rreth 20-25 euro.

Konsumuesit më të shumtë të mariuhanës në Kosovë janë kryesisht rinia shkollore pa dallim gjinie dhe vendet ku më së shumti është duke u shitur kjo substancë është në afërsi të shkollave të mesme dhe në kafiteri të cilat frekuentohen kryesisht nga të rinjtë, duke përfshirë edhe klubet e natës.

Duke marrë parasysh që në të kaluarën është menduar që përdorimi i mariuhanës nuk krijon vartësi tek përdoruesit, gjatë viteve të kaluara nuk ka qenë evidente gatishmëria për të kërkuar trajtim në ndonjërin nga qendrat e specializuara për trajtim, mirëpo gjatë vitit 2014 vërehet një ndryshim në qasjen ndaj përdorimit të kësaj lëndë narkotike. Sipas të dhënave statistikore nga OJQ Labyrinth për vitin 2014 nga gjithsejtë 85 persona të cilët kanë marrë trajtim në këtë qendër, 50 prej tyre apo shprehur në përqindje 58.82% përdorin mariuhanën si lëndë narkotike primare.

Heroina

Sipas të dhënave policore mbi konfiskimin e lëndëve narkotike në Kosovë, nga viti 2013 dhe veçanërisht nga viti 2014 vërehet një rënie drastike e sasisë së heroinës së konfiskuar, e cila ndërlihet drejtpërsëdrejti edhe me mungesën e kësaj lëndë narkotike në tregun Evropian, por edhe më gjerë.

Ndër faktorët kryesorë të mungesës të heroinës në tregun Evropian vlerësohet të jenë trazirat dhe konfliktet në vendet e lindjes së mesme, si në Irak dhe Siri, vende të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në trafikimin e kësaj lëndë apo edhe lëndës së parë të Heroinës nga Afganistani, si burim kryesor i prodhimit të Opiumit për në Turqi, prej nga pastaj përmes rrugëve të ndryshme tokësore, duke përfshirë edhe transitin përmes rrugëve të vendeve të Ballkanit dhe detare është bërë transportimi i saj për në vendet e Evropës. Kjo situatë ka ndikuar që grupet e organizuara kriminale ndërkombëtare të vihen në kërkim të rrugëve dhe tregjeve alternative.

Në sasi dukshëm më të vogël, por bazuar në kërkesën e lartë që vazhdon të jetë prezentë në tregun Evropës për këtë lëndë narkotike, akoma vazhdon të jetë në dukje transportimi i heroinës përmes vendeve të cilat ballafaqohen me trazira të brendshme dhe konflikte të armatosura. Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, ekziston dyshimi i bazuar që grupet e organizuara kriminale ndërkombëtare në bashkëpunim me grupet e ndryshme ekstremiste dhe ato terroriste janë të përfshira në trafikimin e heroinës, duke ngritur dyshimin se një pjesë e profitit nga kjo veprimtari kriminale vihet në dispozicion të financimit të aktiviteteve të këtyre grupeve ekstremiste dhe atyre terroriste.

Ky bashkëdyzim i aktiviteteve në mes të grupeve të organizuara kriminale dhe atyre ekstremiste apo terroriste, si dhe si pasojë e disproporcionit në mes të kërkesës në raport me ofertën ka ndikuar edhe në ngritjen e çmimit të heroinës në përgjithësi në tregun Evropian, duke përfshirë edhe rritjen e çmimit të saj edhe në Kosovë.

Sipas vlerësimeve nga agjencionet dhe organizatat ndërkombëtare që merren me vlerësimin nga krimi i organizuar në përgjithësi dhe trafikimit me lëndë narkotike në veçanti, apo edhe

vlerësimeve nga burimet e hapura është llogaritur që Kosova gjendet në një rëndësi të lartë të trafikimit ndërkombëtar të substancave narkotike të llojit heroinë, por edhe në një rëndësi të lartë të trafikimit ndërkombëtar të substancave tjera si marihuana e kokaina.

Mirëpo bazuar në të dhënat e Policisë së Kosovës mbi sasinë e konfiskimit të heroinës në këto pesë vitet e fundit, që nga viti 2010, vërehet që kjo sasi e heroinës së konfiskuar është relativisht e ulët që të përmbushë kërkesën e tregut të brendshëm në një rëndësi të lartë dhe të tregut evropian në një rëndësi të lartë.

Ndër arsytet të cilat kanë ndikuar në krijimin e perceptimit se Kosova është vend kryesor transiti i trafikimit të heroinës, vlerësohet të jetë përfshirja e qytetarëve me origjinë nga Kosova në aktivitete kriminale në vendet të cilat ata jetojnë dhe lidhjeve të tyre të ngushta që mbajnë me të afërmit e tyre në Kosovë, duke përfshirë edhe dërgimin e remitencave.

Lloji i drogës	2012	2013	2014	2015
Heroina	94.1 kg	22.4 kg	9.6 kg	9.6 kg

Tabela 3 - Konfiskimet e Heroinës në R. Kosovës në periudhën 2012-2015

Duke marrë parasysh profitin relativisht të lartë nga veprimtari kriminale, disa grupe të organizuara kriminale nga Kosova në bashkëpunim me grupet e organizuara kriminale nga vendet e rajonit dhe më gjerë, edhe pse në sasi më të vogla janë të përfshira në trafikimin e heroinës për në vendet e Evropës Perëndimore.

Transporti i heroinës përmes Kosovës kryesisht bëhet me vetura private, apo edhe agjencionet turistike, duke shfrytëzuar diasporën Kosovare në vendet e Evropës Perëndimore, të cilët vizitojnë shpesh Kosovën. Megjithatë duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të Kosovës për prodhimin e mallrave me qëllim të eksportit, mungesën e kompanive për transportimin e mallrave, apo edhe vështirësitë që kanë qytetarët e Kosovës për të lëvizur lirshëm për në vendet e BE-së, Kosova gjithnjë e më pak shihet si një vend atraktiv me qëllim të trafikimit të lëndëve narkotike përmes territorit të saj.

Kryesisht janë identifikuar grupe të vogla, aktiviteti të cilave ka qenë kryesisht në transportin e heroinës për në Kosovë edhe nga Kosova për në vendet e Evropës Perëndimore. Rezultatet hetimore ndaj këtyre personave apo grupeve të vogla, duke pasur parasysh edhe pengesat dhe vështirësitë që hasin këto institucione në trajtimin e këtyre rasteve, si pasojë e mos anëtarësimit në institucionet e sigurisë në nivel rajonal apo edhe global, nuk kanë rezultuar në analizimin e plotë të aktivitetit apo edhe vet strukturës së mundshme të këtyre grupeve të organizuara kriminale.

Karakteristikë e këtyre grupeve të organizuara kriminale është aftësia e tyre e përshtatjes apo edhe e përfshirjes në më shumë se një aktivitet kriminal. Janë regjistruar raste kur i njëjti grup i organizuar kriminal është i përfshirë në trafikimin e heroinës, por edhe të mariuhanës në të

njëjtën kohë. Kjo vlerësohet të jetë si rezultat i kërkesave në treg, por edhe shfrytëzimi i të njëjtave resurse njerëzore dhe materiale, duke përfshirë edhe rrugën e njëjtë të transportit.

Sipas të dhënave nga OJQ Labyrinth nga gjithsejtë 1084 persona që janë trajtuar në këtë qendër nga viti 2002 rreth 115 persona kanë pasur infeksione apo probleme shëndetësore, ndërsa vetëm gjatë vitit 2014 gjithsejtë 5 persona edhe pse këto të dhëna nuk qartësojnë nëse këta persona janë përdorues vetëm të heroinës, ndërsa numri i atyre që kanë përjetuar mbidozë nga viti 2002 është 276. Ndërsa sipas të dhënave nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore vetëm gjatë vitit 2014 janë shënuar 10 raste të dyshuara të vdekjes nga mbidoza apo si pasojë e përzierjes së drogave më substanca të rrezikshme, mirëpo këto të dhëna nuk janë akoma të konfirmuara plotësisht dhe nëse janë të shkaktuara vetëm nga heroina.

Përdoruesit e heroinës në mungesë të institucioneve të mjaftueshme për strehimin dhe trajtimin e tyre, ata bëhen barrë e familjes, rrethit por edhe shoqërisë në përgjithësi. Sipas të dhënave nga OJQ Labyrinth shumica dërmuese e personave që janë trajtuar në këtë qendër janë të papunë dhe të njëjtit hasin në vështirësi për sigurimin e dozës për përdorim dhe synojnë që me çdo kusht të arrijnë deri tek mjetet për blerjen e heroinës për përdorim. Shumë prej këtyre personave edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, përfshihen në aktivitete kriminale, posaçërisht të vjedhjeve dhe grabitjeve. Sipas të dhënave nga OJQ Labyrinth nga gjithsejtë 1084 persona që janë trajtuar në këtë qendër 529 prej tyre kanë qenë të burgosur, mirëpo këto të dhëna përfshijnë përdoruesit e lëndëve narkotike në përgjithësi dhe jo vetëm të heroinës, mirëpo përqindja më e lartë e tyre përdorin heroinën si drogë primare.

Duke marrë parasysh nivelin e kërkesës në raport me uljen e nivelit të ofertës janë shënuar edhe ngritje të çmimit të heroinës në treg. Aktualisht çmimi për një kilogram heroinë sillet nga 17.000 - 22.000 Euro, varësisht nga cilësia, ndërsa çmimi për një dozë rreth 0.6 gram sillet nga 20-25 Euro.

Këto çmime duke marrë parasysh gjendjen ekonomike kryesisht jo të mirë të përdoruesve dhe nivelin e lartë të papunësisë në mesin e tyre janë pothuajse të pa përballueshme për shumicën e tyre, të cilët përveç përfshirjes në aktivitete kriminale tentojnë të gjejnë edhe droga më të lira me përzierje më të lartë të substancave tjera apo edhe keqpërdorin barna të ndryshme, duke përfshirë edhe metadonin të cilin e sigurojnë në tregun e zi apo edhe në barnatore ku e marrin pa përshkrim të mjekut edhe pse një gjë e tillë është e ndaluar me ligj, duke tentuar që sado pak të zëvendësojnë nevojën për marrjen e dozës së heroinës.

Heroina e cila gjendet në Kosovë, veçanërisht e asaj sasive e cila është e destinuar për përdorim të brendshëm gjendet e përzier me substanca të ndryshme, duke përfshirë kafeinën, medikamente të ndryshme, duke përfshirë edhe substanca të rrezikshme, pasi që heroina e destinuar për përdorim, që nga trafikantët e deri tek përdoruesit kalon nëpër disa stërshitës, ku secili prej tyre synon profitin e tij.

Megjithatë edhe pse këto përzierje janë evidentuar gjatë analizave laboratorike nga Agjencinë i Forenzikës, këto analiza nuk janë të detajuara pasi që në mungesë të personelit dhe hapësirës

së mjaftueshme heroina e konfiskuar nuk iu nënshtrohet analizave të detajuara mbi cilësinë, përkatësisht paraqitjes së përqindjes të përmbajtjes së heroinës dhe substancave tjera.

Këto analiza, të cilat parashihen edhe sipas strategjisë nacionale kundër drogave janë të domosdoshme për vërtetuar nëse sasia e heroinës së konfiskuar ka qenë e destinuar për tregun e jashtëm apo për përdorim brenda vendi. Po ashtu përmes këtyre analizave ekziston edhe mundësia e identifikimit se cili grup ka qenë i përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

Kokaina

Kokaina edhe pse është një ndër drogat që janë të njohura në Kosovë vite me radhë, megjithatë prezenca në tregun e brendshëm është relativisht e ulët. Në përgjithësi kokaina e konfiskuar në Kosovë është hasur në sasi të vogla dhe kryesisht tek personat që janë përdorues të saj, apo edhe stërshitës, mirëpo deri më tani, me përjashtim të një rasti gjatë vitit 2014 në rajonin e Pejës nuk është identifikuar ndonjë grup i organizuar kriminal që merret me trafikimin e kokainës.

Megjithatë edhe ky rast në të cilin është identifikuar një grup i organizuar kriminal është bërë gjatë një operacioni të përbashkët me policinë Shqiptare, ku janë konfiskuar rreth 20 kg kokainë, prekursorët dhe acid, të cilat ishin të deponuara në një objekt banimi, e cila ka qenë e destinuar për përzierjen dhe përgatitjen e kokainës. Hierarkia e këtij grupi kriminal është me bazë në Shqipëri, në bashkëpunim me disa persona nga Kosova. Në këtë rast territori i Kosovës është përdorur vetëm si strehë e sigurt për përzierjen dhe përgatitjen e kësaj substance, ndërsa e njëjta ka hyrë në Kosovë nga Shqipëria. Sipas rezultateve hetimore një nga personat e arrestuar në Kosovë, por me shtetësi Shqiptare dhe Amerikane është Kimist. Pas përzierjes kjo sasi e kokainës është planifikuar që përsëri të transportohet në territorin e Shqipërisë.

Mbështetur në statistikat policore dhe të qendrave që operojnë në territorin Kosovës, numri i personave të varur nga abuzimi me substanca narkotike është i vogël si përdorues i kësaj kategorie të drogës. Sipas të dhënave nga OJQ Labyrinth numri i personave që kanë kërkuar trajtim në këtë qendër që nga viti 2002, ku përdorimin e drogës së parë kanë pasur kokainën janë gjithsej 65 kurse si drogë primare përdorin kokainën është 12, ndërsa vetëm gjatë vitit 2014 në këtë qendër janë trajtuar gjithsej 4 persona përdorues të kokainës si drogë primare.

Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës çmimi i Kokainës në treg për një kilogram sillet mes 60.000 - 80.000 Euro, ndërsa për një dozë prej 0.6 gr sillet mes 70 - 90 Euro

Sipas të dhënave policore mbi konfiskimin e lëndëve narkotike në Kosovë gjatë viteve 2012 - 2014 është shënuar një rritje e sasisë së kokainës së konfiskuar.

Lloji	2012	2013	2014	2015
Kokaina	7.4 kg	3.3 kg	21.1 kg	0.054 kg

Tabela 4- Konfiskimi i substancës narkotike Kokaina në Kosovë gjatë viteve 2012 - 2015

Ekstazia

Përdorimi i kësaj substance narkotike në Republikën e Kosovës është mjaft i ulët, pasi që efekti i kësaj substance është pothuajse i njëjtë me efektin e mariuhanës, ndërsa çmimi i saj krahasuar më çmimin e mariuhanës është shumë më i lartë. Kjo lloj substance kryesisht është e evidente në tregun Evropian, ndërsa në Kosovë hyn kryesisht përmes rinisë së diasporës gjatë vizitës së tyre në Kosovë. Sa i përket kësaj droge nuk ka informacione të mjaftueshme për të dhe nuk është shënuar përfshirje e ndonjë grupi të organizuar kriminal apo konfiskim në sasi të mëdha.

TRAFIKIMI ME NJERËZ

Në periudhën e pas luftës, grupet e organizuara kriminale nga Kosova dhe vendet fqinje, por edhe më gjerë, të cilat duke përfituar edhe nga fakti që legjislacioni i adoptuar nga administrata e UNMIK-ut nuk parashihte trafikimin e qenieve njerëzore si vepër penale (me përjashtim të prostitucionit e cila parashihej vetëm si kundërvajtje) kanë sjellur në Kosovë një numër të konsiderueshëm të viktimave të trafikuar me qëllim të shfrytëzimit seksual. Origjina e viktimave të trafikimit ishte nga disa vende më të varfra të Evropës dhe Euro-Azisë, siç ishin Rumania, Moldavia, Ukraina, Bullgaria dhe vende tjera. Mungesa e legjislacionit për sanksionim të këtij fenomeni dhe prezenca e një numri të madh të ndërkombëtarëve në Kosovë të cilët janë vlerësuar si klientelë mjaft profitabile, kanë qenë avantazh për grupet e organizuara kriminale.

Nuk ka informacione të mjaftueshme mbi mënyrën e trafikimit të këtyre viktimave dhe mënyrën e transportimit të tyre deri në Kosovë, mirëpo të njëjtat kryesisht vendoseshin në dispozicion të klubeve dhe lokaleve të natës, të cilat ishin mjaft të përhapura pothuajse në të gjitha rajonet e Kosovës, të cilat regjistroheshin si punëtore apo valltare në këto lokale, mirëpo në të njëjtën kohë detyroheshin të ofronin edhe shërbime seksuale për klientët e këtyre lokaleve.

Duke marrë parasysh trendin në rritje të kësaj dukurie, me datë 19.01.2001 administrata e UNMIK-ut përmes një rregullore të veçantë nr: 2001/4 parashih Trafikimin me Qenie Njerëzore si vepër penale dhe më vonë kjo vepër parashihet edhe në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës të viti 2004.

Legjislacioni i Kosovës në këtë aspekt është avancuar vazhdimisht dhe Kodi Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013 është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të OKB-së për luftimin e krimit të organizuar, si dhe në Protokollin e Palermos për Trafikimin e Qenieve Njerëzore të vitit 2000.

Sipas Kodit Penal të Kosovës termi "trafikim me njerëz" do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit me pushtetin ose abuzimit të

pozitës së ndjeshme ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.

Ndërsa "shfrytëzimi" përfshin këto forma si në vijim:

- Shfrytëzimin e shërbimit të prostitucionit,
- Pornografisë ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual,
- Lëmoshës,
- Shërbimeve ose punës së detyruar,
- Skllavërisë ose praktika të ngjashme me skllavërinë,
- Robërisë ose heqjen e organeve dhe qelizave.

	2012	2013	2014	2015
Trafikim me njerëz	34	38	28	24
Mundësim i prostitucionit	28	18	24	23
Vepra tjera të trafikimit me njerëz	38	15	21	18

Tabela 5- Numri i rasteve që nderlidhen me veprat penale të Trafikimit me njerëz gjatë viteve 2012 - 2015

Bazuar në statistikat e paraqitura në tabelën nr.5 vërehet një rënie e lehtë e vazhdueshme e rasteve të trafikimit me njerëz. Gjithashtu edhe statistikat e veprave tjera penale që ndërliken me natyrën e kësaj vepre penale numri i rasteve është relativisht i njëjtë.

Viktimat e Trafikimit

Sipas të dhënave policore nga viti në vit është shënuar ulje e numrit të viktimave të huaja të trafikimit, mirëpo nga ana tjetër është shënuar rritje e viktimave vendore të trafikimit, posaçërisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, duke përfshirë edhe viktimat e mitura mes moshës 15 - 17 vjeçare, që janë më të cenueshme /prekura, për shkak të faktorëve të ndryshëm si p.sh:


- moskujdesi i duhur prindëror dhe familjar,
- kushtet e vështira ekonomiko-sociale (varfëria)
- braktisja e shkollimit
- mungesa e perspektivës
- niveli i lartë i papunësisë
- pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave
- konflikti dhe situatat pas konfliktit
- mungesa e integritetit shoqëror
- mungesa e qasjes në arsim

Natyrë e krimit të trafikimit me njerëz në Kosovë konsiderohet se është konspirative/fshehur dhe shumica e viktimave janë të kërcënuara, shantazhuara, frikësuara dhe të mashtruara duke u shfrytëzuar në mënyrë sistematike nga trafikantët, prandaj viktimat nuk vet-deklarohen (nuk i raportojnë rastet në Polici), dhe as nuk kanë guxim të flasin për gjendjen në të cilën ndodhen edhe kur zbatuesit e tjerë të ligjit janë në kontakt dhe bisedojnë me to. Gjithashtu përgjithësisht publiku e percepton këtë lloj të krimit si diçka që bëhet edhe me vullnetin dhe dëshirën e vet viktimave.

Vitet	Kosovare	Moldave	Shqiptare	Serbe	Tjera	Totali
2012	29	23	1	0	1	54
2013	44	0	7	1	0	52
2014	36	0	4	1	1	42
2015	25	0	4	1	0	30

Tabela 6- Viktimat e trafikimit të identifikuar sipas origjinës 2012-2015

Në këtë tabelë janë paraqitur numri i viktimave sipas përkatësisë shtetërore nëpër vite. Sipas të dhënave në këtë tabelë vërehet një trend i uljes së vazhdueshme të viktimave të identifikuar të trafikimit, posaqërisht gjatë vitit 2015.



Grafkoni 1 - Viktimat e Trafikimit sipas grup-moshave 2012-2015

Paraqet viktimat sipas grup moshave, ku siç shihet në grafit grup mosha më e prekur është 14-17 vjeçare, pasuar nga grup mosha 18-22, 23-25 etj. Ndërkaq grup mosha mbi 51 vjeçare rezulton me zero (0) viktima.

Faktorët që ndikojnë në trafikimin me njerëz

Në trendet aktuale të trafikimit në Kosovë kanë ndikuar dy lloj faktorësh:

Faktorët e brendshëm - që kanë ndikuar në këtë ndryshim të trendit të trafikimit konsiderohen: nxjerrja e ligjeve të reja, Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, Ligji për të huajt, Zbatimi i regjimit të vizave nga Kosova për 87 shtete të botës etj. Të gjitha këto ligje kanë ndikuar që të krijohen barriera dhe pengesa shtese për trafikantet që ata ta kenë më të vështirë rekrutimin e viktimave nga shtetet tjera dhe transportimin dhe sjelljen e tyre në Kosovë, prandaj në fokus të trafikantëve tashmë janë viktimat vendore.


Faktorët e jashtëm - po ashtu kanë ndikuar në këtë çështje si p.sh zgjerimi i Bashkimit Evropian me vendet e lindjes Rumani, Bullgari, heqja e vizave për vendet e Ballkanit dhe për këtë arsye Kosova nuk është më vend i preferuar i destinacionit, pasi qytetarët (viktimat potenciale) nga këto vende tashmë lëvizin lirshëm në vendet e Evropës Perëndimore. Shumica e viktimave të trafikimit ende gjenden/lokalizohen dhe identifikohen në lokale nate, bare, restaurante, por janë rritur edhe rastet kur viktimat identifikohen edhe në shtëpi private/apartamente etj.

Megjithatë identifikimi i viktimave të trafikimit vazhdon të mbetet sfida për të gjitha institucionet e Kosovës të përfshira në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, përfshirë këtu edhe shoqërinë në përgjithësi. Edhe më tutje ekziston perceptimi në shoqëri në përgjithësi, por edhe nga familja e viktimave të trafikimit, se viktimat nuk detyrohen të përfshihen në këto aktivitete, por që sipas tyre ato janë të përfshira vullnetarisht në aktivitete të tilla. Andaj si rezultat i kësaj edhe më tutje identifikimi i viktimave kryesisht bëhet nga Policia e Kosovës, përmes rrugëve operative dhe në bazë të inteligjencës paraprake.

Edhe më tutje si pasojë e presionit dhe frikës nga personat e dyshuar, viktimat e trafikimit hezitojnë të bashkëpunojnë me institucionet e sigurisë dhe në raste të caktuara edhe përkundër faktit që ekziston dyshimi i bazuar që ato janë viktimat të trafikimit, vështirë merret pohimi nga ana e tyre.

Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit në Kosovë

Statistikat e rasteve të hetuara tregojnë se Prostitucioni në Kosovë është forma kryesore e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit, kurse format tjera të shfrytëzimit siç janë: pornografia ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimet dhe puna e detyruar, skllavëria ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve dhe qelizave janë të pakta.



Shfrytëzimi i prostitucionit
 Pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit
 Shërbimeve ose punë e detyruar
 Shfrytëzimi për mes Kërkim-lëmoshës

Grafikoni 2- Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit 2012 - 2015


Në 80% të rasteve format e shfrytëzimit janë Shfrytëzim i prostitucionit, 13% Shërbimeve ose punë e detyruar, në 6% Shfrytëzim për mes Kërkim-lëmoshë, ndërkaq në 1% Pornografi ose forma tjera të shfrytëzimit.

Metodat e rekrutimit në rastet e trafikimit me njerëz

Metodat e rekrutimit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra tjetra dhe varen nga mënyra e veprimit dhe niveli i organizimit të trafikantëve, si dhe nga lloji i grupit të synuar (gra/fëmijë/jetimë/anëtarë të minoriteteve) etj.

Kryesisht trafikantët përdorin këto mënyra të rekrutimit:

- Ofertat për vende pune - (kameriere, valltare, banakiere etj) ku u premtohen paga të mira mujore.
- Premtime të rrejshme për martesë apo bashkëjetesë.
- Mashtrimi me anë të premtimeve gjysmë të vërteta, si për shembull mundësia për të punuar në kushte të paligjshme, por jo në kushte të rënda shfrytëzuese apo skllavëruese, ose për heqjen e organeve apo pjesëve të trupit, por pa informuar mbi pasojat e mundshme shëndetësore.
- Kontakti përmes ueb-faqeve të internetit (facebook, tëiter, badoo etj) - kontaktohen femra të reja nga persona të ndryshëm.



Grafikoni 3 - Statistikat sipas mënyrës së rekrutimit të viktimave 2012 - 2015

Paraqet mënyrat e rekrutimit të viktimave, ku në 53% janë oferta për vende pune, 28% premtime për martesë/bashkëjetesë, 18% mashtrimi për jetë më të mirë dhe në 1% kontaktet përmes rrjeteve sociale.

Arrestimet e personave të përfshirë në trafikimin me njerëz

Gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta të trafikimit me njerëz nuk është arritur që të identifikohet ndonjë grup i strukturuar, por trendet e trafikimit në Kosovë aktualisht janë duke shkuar në drejtim të organizmit të rrjeteve individuale të kriminalitetit.

Trajtimi dhe hetimi i rasteve të trafikimit me njerëz në kuadër të Policisë së Kosovës bëhet nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, personeli i së cilës ka krijuar përvojë dhe ekspertizë të mjaftueshme për trajtimin e rasteve të trafikimit, megjithatë personeli i kësaj drejtorie në raste të caktuara janë të tej ngarkuar me detyra tjera, pasi që përveç rasteve të trafikimit me njerëz, trajton edhe rastet tjera që ndërlidhen me rastet e Trafikimit.

Personat e arrestuar	2012	2013	2014	2015
Trafikim me njerëz	121	91	66	48
Mundësim i Prostitucionit	39	35	35	37
Prostitucion	61	26	49	70
Vepra tjera	7	30	11	23
TOTAL	228	182	161	178

Tabela 7 - Statistikat e personave të arrestuar 2012- 2015

Numri i personave të arrestuar për veprat penale të trafikimit me njerëz, mundësim prostitucioni dhe veprave tjera të ngjashme penale gjatë viteve 2014 dhe 2015 është relativisht

më i ulët se sa gjatë viteve 2012 dhe 2013. Kjo ndërlidhet edhe me numrin më të ulët të rasteve të inicuar dhe viktimave të identifikuar gjatë viteve 2014 dhe 2015.

Numri i shqiptimit të masave ndëshkuese ndaj personave të dyshuar të përfshirë në format e trafikimit me njerëz vazhdon të mbetet relativisht i ulët dhe kjo si pasojë e disa faktorëve:

- Vështirësi në sigurimin e provave dhe dëshmive gjatë zhvillimit të hetimeve
- Dëshmitarët e mundshëm pothuajse nuk bashkëpunojnë fare në ofrimin e dëshmive.
- Ndryshimi i deklaratave nga ana e viktimave të trafikimit, të cilat në raste të caktuara të gjendura përballë presionit dhe frikës për veten e tyre apo edhe për familjen vendosin të ndryshojnë deklaratat e tyre.
- Stërzgjatja e proceseve gjyqësore, viktimat e trafikimit, posaçërisht ato të grup moshave të reja është e vështirë që të sigurohet prezenca e tyre gjatë shqyrtimit të lëndëve në Gjykatë, sidomos në rastet kur viktimat e trafikimit kanë krijuar familje.
- Niveli jo i kënaqshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar

Mbrojtja e viktimave dhe Ri-integrimi

Mbrojtja e viktimave të trafikimit mbetet një sfidë për institucionet e Republikës së Kosovës edhe përkundër faktit se është bërë një përparim në krijimin e kushteve të përshtatshme për ofrimin e masave të mbrojtjes, strehimit dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit.

Bashkëpunimi dhe kontributi i organizatave të shoqërisë civile është i rëndësishëm së veçantë, në veçanti ato të cilat ofrojnë shërbime të specializuara dhe ekspertizë në trajtimin e kësaj problematike të ndejshme. Qeveria e Republikës së Kosovës ka përkrahur çështjet e mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit dhe gjatë vitit 2012 ka ofruar mbështetje për 43 viktima të trafikimit, përderisa në vitin 2013 ka ofruar përkrahje për 52 viktima të trafikimit.

Në Kosovë aktualisht ekzistojnë tri qendra të strehimit të viktimave të trafikimit, një qendër strehimi shtetërore në të cilën kryesisht strehohen viktimat e trafikimit të cilat sipas vlerësimit paraprak vlerësohet se paraqesin nivel të mesëm apo të lartë të rrezikshmërisë, si dhe dy qendra tjera strehimi të cilat menaxhohen nga organizata jo qeveritare në të cilat strehohen viktimat me nivel të ulët të rrezikshmërisë.

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019 fuqizon përpjekjet institucionale dhe të tërë shoqërisë Kosovare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Gjithmonë duke marrë parasysh rekomandimet që dalin nga raportet e organizatave ndërkombëtare, raportet e Komisionit Evropian si dhe partnerëve vendor dhe ndërkombëtar

nga sektori privat dhe shoqërisë civile, me qëllim dhe synim të përbashkët, parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e fenomeneve kriminale si ato të trafikimit me njerëz.

Strategjia kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë reflekton objektivat strategjike në përputhje të plotë me Strategjinë e BE-së për ç'rrënjosjen e Trafikimit me njerëz 2012-2016 dhe me adresim të problematikës në kontekst vendor dhe rajonal.

Raportimet nga Agjencitë dhe Organizatat Ndërkombëtare

Luftimi i trafikimit me qenie njerëzore vazhdon të jetë një ndër kushtet e vëna nga Bashkimi Evropian (BE) për Kosovën. Në këtë drejtim janë dhënë disa vërejtje në Raportet e Progresit për Kosovën, si dhe në raportet e progresit për përmbushjen e kushteve në lidhje me Udhëzuesin për Liberalizimin e Vizave. Me përjashtim të BE-së, edhe Raporti në lidhje me Trafikimin me Qenie Njerëzore i Departamentit Amerikan të Shtetit ka vënë në pah se, Kosova vazhdon të jetë burim dhe vend transiti i trafikimit me qenie njerëzore. Për më tepër, raporti thekson se Qeveria e Kosovës nuk vepron plotësisht në bazë të standardeve minimale të përcaktuara për eliminimin e trafikimit, edhe pse është duke bërë përpjekje të dukshme për të vepruar në atë drejtim.

Që nga viti 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, ka pasur kritika të ngjashme drejtuar ndjekjes joefektive dhe dënimit joadekuat të krimit të trafikimit. Mekanizmat plotësues ligjor dhe institucional janë krijuar në Kosovë duke filluar nga njësitë e specializuara në hetimin e trafikimit brenda Policisë së Kosovës, institucionet për mbrojtjen e viktimave në mënyrë që të adresohet çështja e përfaqësimit të viktimave të trafikimit pranë gjykatave, si dhe janë krijuar shërbimet e specializuara të OJQ-ve me qëllim të ofrimit të ndihmës ndaj viktimave të trafikimit. Megjithatë, qasja ka mbetur e përqendruar më tepër tek mbrojtja dhe parandalimi i trafikimit se sa tek kryerja e hetimeve serioze penale për të kapur grupet e organizuara të trafikimit dhe dënimin e duhur të autorëve të krimit të trafikimit.

Ndjekja dhe dënimi i rasteve të trafikimit me njerëz

Gjatë vitit 2014 autoritetet gjyqësore kanë vazhduar të ofrojnë një nivel të ulët të ndjekjes dhe dënimit të krimeve të trafikimit me njerëz. Të dhënat e dobëta kanë rezultuar nga grumbullimi i lëndëve nëpër gjykatat e Kosovës, nga mungesa e vazhdueshme e prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar në trajtimin e shkeljeve penale në lidhje me rastet me trafikimin me qenie njerëzore, dhe si rezultat i hezitimit të viktimave të trafikimit për të bashkëpunuar me autoritetet e sundimit të ligjit⁶.

⁶KIPRED: Kërkesat e BE-së për Kosovën: lufta kundër trafikimit me njerëz

Gjatë vitit 2014 në të gjitha zyrat e Prokurorisë Themelore të Kosovës janë proceduar gjithsej 66 raste të trafikimit me njerëz kundër 181 personave. Megjithatë, shërbimet për ndjekje penale kanë arritur që të zgjidhin vetëm 22 raste kundër 56 personave, apo 33% të tyre. Nga fundi i vitit kanë mbetur të pazgjidhura 44 raste të trafikimit me qenie njerëzore kundër 125 personave, apo në përgjithësi 67% e tyre⁷.

EKSTREMIZMI DHE RADIKALIZMI

Republika e Kosovës edhe pse deri më tani nuk është përballur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sulme të mundshme terroriste apo kërcënime të drejtpërdrejta për sulme të tilla, megjithatë zhvillimet e fundit në nivel kombëtar, rajonal, por edhe global kanë ndikuar edhe në krijimin e rrethanave dhe sfidave të reja me të cilat ballafaqohen Institucionet e vendit, por edhe shoqëria Kosovare në përgjithësi.

Përkundër zhvillimeve politike në vend, arritja e disa marrëveshjeve si rezultat i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë dhe progresi i arritur në zbatimin praktik të këtyre marrëveshjeve edhe më tutje vazhdon të jetë prezentë aktiviteti i disa individëve apo grupeve të caktuara me ideologji ekstreme nacionaliste, të cilat paraqesin kërcënim për vendin. Këta individ dhe grupe kryesisht janë të përqendruar në Veri të vendit, ku edhe më tutje Institucionet e Republikës së Kosovës vazhdojnë të hasin në vështirësi në zbatimin e plotë të ligjshmërisë dhe funksionalizimit të plotë të mekanizmave institucional dhe shtetëror.

Individ dhe grupe të caktuara, kryesisht në veri të vendit nën petkun e nacionalizmit janë të përfshira në aktivitete të ndryshme kriminale dhe krimin të organizuar, të cilat në emër të nacionalizmit keqpërdorin popullatën e veriut të vendit për mbrojtjen e bizneseve të tyre kriminale.

Mirëpo ngjashëm me vendet tjera të rajonit, por edhe më gjerë, kërcënim tjetër aktual për Republikën e Kosovës, vazhdon të mbetet trendi i përhapjes dhe ndikimit të ideologjive ekstremiste të cilat keqpërdorin religjionin për arritjen e qëllimeve të tyre të cilat bazohen në jo tolerancë, urrejtje ndërfaqetare, ndërsektare dhe ngritje kundër sistemit demokratik dhe synimeve properëndimore të Republikës së Kosovës.

Deri më tani, përveç disa rasteve të izoluar të dhunës kryesisht ndaj pjesëtarëve të "moderuar" të islamit nuk ka pasur ndonjë rast i cili cenon drejtpërdrejt sigurinë e përgjithshme. Megjithatë, është shqetësues fakti i pjesëmarrjes së një numri të shtetasve të Republikës së Kosovës në konfliktin në Siri dhe Irak në radhët e organizatave terroriste ISIS dhe Al-Nusrah dhe përfshirjes të disa prej tyre në akte të drejtpërdrejta të dhunës, por edhe në akte terroriste.

⁷ Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2014, Raporti Vjetor Ndër-Institucional mbi Harmonizimin e Statistikave, faqe 69. I disponueshëm tek,

Luftëtarët e parë nga Republika e Kosovës iu kanë bashkangjitur këtij konflikti nga mesi i vitit 2012, të cilët fillimisht ishin në numër relativisht të vogël dhe kryesisht iu janë bashkangjitur Ushtrisë së Lirë të udhëhequr nga Opozita Siriane, ndërsa më vonë luftëtarët nga Republika e Kosovës kanë filluar që të jenë pjesë e organizatave terroriste, fillimisht Al-Nusrah ndërsa më pas ISIS, në të cilën organizatë aktualisht janë të inkuadruar shumica e luftëtarëve nga Republika e Kosovës. Sipas të dhënave të deritanishme udhëtimi i Kosovarëve për në zonën e konfliktit kryesisht është bërë përmes rrugëve ajrore nga aeroportet e Prishtinës, Shkupit dhe Tiranës në drejtim të Stambollit. Megjithatë janë evidentuar disa raste në numër më të vogël kur disa persona kanë udhëtuar apo kanë tentuar të udhëtojnë përmes rrugëve ilegale, përmes Maqedonisë, Bullgarisë etj. Mirëpo deri më tani nuk është arritur të evidentohet ndonjë rast që ata të jenë ndihmuar nga ndonjë grup i organizuar kriminal nga Kosova.

Duke marr parasysh që në shumicën e rasteve personave të cilët iu bashkohen grupeve terroriste në zonën e konfliktit iu merren dokumentet e udhëtimit, ekziston dyshimi që të njëjtit në rast se vendosin të kthehen në Kosovë do arrijnë përmes rrugëve ilegale, me ndihmën e grupeve të organizuara kriminal, apo duke u fshehur në mesin e refugjatëve.

Motivet që i kanë shtyrë këta individë të marrin pjesë në këtë konflikt janë të ndryshme, duke filluar nga aspekti humanitar, përfitim material, s dhe ne raste të izoluara për çështje ideologjike. Duhet potencuar që disa nga Kosovarët që udhëtojnë për në zonën e konfliktit nuk e bëjnë me qëllim që të marrin pjesë aktive në luftime, por siç mendojnë ata të jetojnë në "shtetin islam" dhe sipas parimeve "islame".

Trendi i deritanishëm i radikalizmit të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe i pjesëmarrjes së tyre në zonat e konfliktit jashtë vendit ndërliqhet edhe si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomiko - sociale që mbretëron në Republikën e Kosovës, posaçërisht shtresa të caktuara të shoqërisë, të cilat janë të ekspozuara ndaj ndikimit nga elemente të caktuara radikale dhe ideologjive ekstreme, të cilat kryesisht shenjëzojnë këtë shtresë të shoqërisë, përmes kontakteve të drejtpërdrejta nga individ të caktuar, përmes ligjëratave nga disa imam radikal, apo edhe përmes propagandës në internet, posaçërisht në rrjetet sociale.

Bazuar në të dhënat që janë në dispozicion të Institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës deri më tani numri i Kosovarëve të cilët kanë marrë pjesë në periudha të caktuara në zonën e konfliktit është rreth 300 persona, duke përfshirë edhe rreth 50 persona të cilët besohet të jenë vranë dhe rreth 140 të tjerë të cilët besohet se aktualisht gjenden në zonën e konfliktit (në këtë numër përfshirë rreth 38 gra dhe 27 fëmijë). Në bazë të profilit të personave të identifikuar nga Institucionet e Sigurisë, personat të cilët iu kanë bashkangjitur janë kryesisht persona që jetojnë në kushte të vështirë ekonomiko - sociale, nivel të ulët të arsimimit, probleme familjare. Sipas këtyre të dhënave mosha mesatare e personave që iu janë bashkangjitur grupeve terroriste në zonën e konfliktit në Siri dhe Irak është mes 18 - 27.

Këta persona, por edhe personat tjerë që mund të radikalizohen si rezultat i propagandës së vazhdueshme, paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj situatës së Sigurisë, rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës, gjithashtu ndikojnë edhe në krijimin e imazhit negativ të Republikës së Kosovës në procesin e integritimeve. Kërcënim tjetër që mund të paraqitet është ngritja e

nivelit të jo tolerancës apo edhe e reagimit shoqëror ndaj ideologjisë apo veprimeve të këtyre individëve, që rrezikon krijimin e grupeve kundërshtuese ekstremiste.

Andaj duke marrë parasysh këto shqetësime dhe kërcënimet që mund të paraqesin këta persona, Policia e Kosovës në bashkëpunim edhe me institucionet tjera relevante kanë ndërmarrë masa konkrete për parandalimin e kësaj dukurie, si dhe sensibilizimin e Institucioneve tjera për nevojën e veprimeve konkrete për parandalimin dhe luftimin e ekstremitetit të dhunshëm dhe terrorizmit. Në këtë kontest duhet veçuar edhe hartimi dhe aprovimin e ligjit për sanksionimin e pjesëmarrjes në konflikte jashtë vendit, ligj I cili kishte ndikim pozitiv në parandalimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës në konflikte jashtë vendit, pasi që përveç sanksioneve të parapara për personat të cilët iu bashkohen organizatave apo formacioneve ushtarake apo paraushtarake, me këtë ligj sanksionohet edhe thirrja për një gjë të ngjashme, duke përfshirë edhe propagandimin në çfarëdo forme.

Institucionet e Kosovës në vazhdimësi kanë shprehur interes dhe gatishmëri që të bashkëpunojnë edhe me bashkësitë fetare, shoqërinë civile, organizatat joqeveritare, duke marrë parasysh që parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe luftimi i terrorizmit nuk mund të arrihet vetëm me një qasje policore, por nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse.

Si rezultat i këtij angazhimi është arritur një pajtueshmëri e plotë që përveç Strategjisë Nacionale kundër Terrorizmit dhe planit të veprimit, Institucionet e vendit në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile dhe komunitetin fetar duhet të angazhohen më tepër në fushën e parandalimit të përhapjes së radikalizmit. Pas disa takimeve dhe debateve gjithëpërfshirëse gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 Institucionet e vendit me pjesëmarrjen aktive edhe të shoqërisë civile, OJQ-ve, komunitetit fetar etj kanë hartuar strategjinë nacionale kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm 2015 - 2020. Përmes kësaj strategjie synohet të ofrohet një qasje gjithëpërfshirëse për identifikimin e hershëm të personave të radikalizuar dhe faktorët shtytës duke u fokusuar në parandalim të përhapjes së radikalizmit,, intervenim si dhe de-radikalizim dhe ri-integrimit të personave të radikalizuar.

Krahas angazhimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e përfshirjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës në konflikte jashtë vendit apo edhe në grupe terroriste, Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale dhe Prokuroritë themelore që nga viti 2013 ka iniciuar hetime penale kundër më shumë se 130 personave nën dyshimin që kanë kryer vepra penale për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist dhe vepra tjera penale nga kapitulli i veprave penale kundër sigurisë dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Si rezultat i këtyre hetimeve është arritur që të arrestohen mbi 100 persona, duke përfshirë persona që kanë qenë pjesëmarrës në konflikte jashtë vendit në radhët e organizatave terroriste, persona që merren me organizimin dhe rekrutim, imam frymëzues dhe promovues të ideologjive radikale, si dhe disa imam militant apo mbështetës të pjesëmarrjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës në konflikte jashtë vendit në radhët e organizatave terroriste. Gjithashtu është arritur që në bashkëpunim me institucionet përkatëse të pezullohet aktiviteti i rreth 15 OJQ-ve, nën dyshimin se të njëjtat veprojnë në kundërshtim me legjislacionin në Kosovë, si dhe të jenë të përfshira në nxitjen e urrejtjes fetare dhe ndërsektare.

MIGRIMI ILEGAL

Migrimi i kategorive të caktuara të qytetarëve kosovar drejt vendeve të Evropës Perëndimore është një dukuri e pranishme, me ngritjet dhe rëniet e veta dhe paraqet shqetësim të vazhdueshëm për institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe për shoqërinë.


Emigrantët kosovar janë të dy gjinive, kryesisht të moshës së mesme dhe të re, të papunë apo të punësuar në sektorin privat, familjarë dhe me fëmijë, të nacionaliteteve sipas përfaqësimit të popullatës së Kosovës.

Emigrantët kosovar, janë kryesisht persona me gjendje të dobët ekonomike, të papunë ose të punësuar kryesisht në sektorin privat, me paga të ulëta dhe mesatare, me asistencë sociale, disa me problem të pazgjidhur strehimi, të pakënaqur me politikat shëndetësore, pensionale, të sigurisë, të arsimimit etj.

Sipas të dhënave nga EUROSTAT lidhur me kërkesat për azil në vendet e BE-së për vitet 2013 dhe 2014, numri i kërkesave nga Kosova janë 20.225 gjatë vitit 2013, të dhëna të cilat e kanë radhitur Kosovën në vendin e gjashtë të vendeve jashtë BE-së qytetarët e të cilës kanë kërkuar azil, ndërsa në vitin 2014 është shënuar një rritje e konsiderueshme e kërkesave nga qytetarët e Kosovës në vendet e BE-së me gjithsejtë 37.895, duke e radhitur Kosovën në vendin e tretë për nga numri i kërkesave për azil, menjëherë pas qytetarëve nga Siria dhe Afganistani. Shprehur në përqindje 6.1% e të gjitha kërkesave të parashtruara për azil në vendet e BE-së janë paraqitur nga qytetarët e Republikës së Kosovës⁸.

Sipas të dhënave nga EUROSTAT trendi i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga qytetarët e Republikës së Kosovës ka vazhduar me ritëm të shtuar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, veçanërisht gjatë muajit Shkurt, në të cilin muaj janë regjistruar 22.460 kërkesa për azil. Gjatë këtij tremujori Kosova është radhitur në vendin e parë për nga numri i kërkesave për azil nga qytetarët e saj, duke lënë prapa edhe qytetarët nga vendet si Siria dhe Afganistani. Mirëpo gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 është shënuar një rënie rapide e numrit të kërkesave për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës.

⁸ [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_\(non-EU\)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_(non-EU)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png) &



Grafiti 4 - Trendi i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës Prill 2014 - Qershor 2015

Bazuar në trendin e kërkesave për azil në vendet e BE-së nga qytetarët e Kosovës nga muaji Prill 2014 deri në Qershor të vitit 2015, vërehet se që nga muaji Tetor 2014 numri i kërkesave për azil ka filluar që të shenjë ngritje, duke arritur kulminacionin gjatë muajit Shkurt 2015, ndërsa që nga muaji Mars 2015 e deri në muajin Qershor 2015 shënohet një rënie e vazhdueshme e numrit të kërkesave për azil. Sipas të dhënave nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) në kuadër të MPB-së, në tabelën në vijim është paraqitur numri i kërkesave për azil nga shtetasit e Kosovës në vendet e BE-së, të paraqitur sipas vendeve të BE-së. Sipas të tabelës në vijim vërehet se gjatë viteve 2012 - 2015 shumica e kërkesave për azil janë parashtruar në Hungari. Mirëpo Hungaria nuk ka qenë destinacion i fundit për migrantët Kosovar, por të cilët për shkaqe të ndryshme kanë ngelur në kampet Hungareze, në mungesë të mundësisë për të udhëtuar, apo duke pritur rastin e përshtatshëm të udhëtimit më tutje.

Shteti	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Jan - Qer 2015	Gjithsejtë
Gjithsejtë	10,335	21,090	38,395	63,375	133,195
Hungari	220	6,210	21,450	23,915	51,795
Gjermani	2,535	4,415	8,910	31,225	47,085
Francë	3,715	5,500	2,775	2,875	14,865
Austri	315	935	1,895	2,280	5,425
Suedi	1,045	1,280	1,485	1,285	5,095
Belgjikë	1,745	1,265	845	505	4,360
Zvicër	0	705	410	390	1,505
Norvegji	135	260	145	150	690
Itali	110	95	100	135	440
Tjera	305	275	235	615	1,930

Tabela 8- Numri i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga Kosovarët 2012 - 2015

Qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët kanë parashtruar kërkesa për azil në vendet e BE-së, kanë hyrë në këto shtete në mënyra të ndryshme, përmes kalimit ilegal të kufirit (kryesisht Serbi-Hungari), falsifikimit ose keqpërdorimit të dokumenteve të udhëtimit (kryesisht

dokumente nga Serbia), përmes hyrjeve legale (duke poseduar viza të ndryshme, por që pas skadimit të vizave kanë kërkuar azil) etj. Megjithatë nuk ekzistojnë të dhëna të sakta lidhur me mënyrën e hyrjes së qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së, mirëpo besohet që dominon kalimi ilegal i kufijve.

Sipas të dhënave nga FRONTEX, përkatësisht të raporteve mbi vlerësimet vjetore të rrezikut që hartohen nga ky agjencion, numri i Kosovarëve që kalojnë ilegalisht kufirin Serbi - Hungari është shtuar dukshëm në tremujorin e dytë të vitit 2014 dhe tremujorin e parë të vitit 2015. Gjatë kësaj periudhe kohore kufiri Serbi - Hungari është shfrytëzuar për kalim ilegal nga qytetarë të vendeve të ndryshme, duke përfshirë edhe ata Sirian, Afgan etj, mirëpo sipas të dhënave nga FRONTEX më shumë se gjysma e rasteve të identifikimit të kalimeve ilegale të kufirit Serbi - Hungari janë shtetas Kosovar.

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e fluksit të migrimit të qytetarëve të Kosovës për në vendet e BE-së, përveç faktorëve të cekur më lart në këtë dokument (ekonomik, social etj), besohet se kanë ndikuar edhe propagandat e ndryshme mediatike, të cilat kanë përhapur thashetheme se kinse vendet e BE-së kanë thjeshtëzuar procedurat për praninë të azilit, se këto vende kanë nevojë për fuqi punëtore nga profesione të ndryshme. Qytetarët e Republikës së Kosovës të joshur nga kjo propagandë dhe duke marrë parasysh koston e ulët të udhëtimit për në vendet e BE-së, kanë pranuar rrezikun që të provojnë fatin e tyre, duke marrë parasysh që edhe mund të kthehen por nuk do të kenë humbje të mëdha ekonomike⁹. Po ashtu ekziston dyshimi që autoritetet Hungareze dhe Serbe në mënyrë të heshtur kanë toleruar kalimet ilegale nëpër kufijtë e tyre.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në uljen e fluksit të lartë të migrimit të qytetarëve të Kosovës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 dhe në vazhdim, janë kthimi i shpejtë i azilkërkuesve në vendin e origjinës (Kosovë), kampanjat mediatike të shteteve përkatëse dhe të institucioneve të Kosovës për dëmin që mund të shkaktohet nga migrimi i paligjshëm, shtrëngimi i masave në kufirin Serbi - Hungari etj.

Emigrimi i Kosovarëve për në vendet e BE-së dëmton në masë të madhe angazhimin e institucioneve në përafrimin e integriteteve euro-atlantike, si dhe në procesin e liberalizimit të vizave. Si kërcënim tjetër me të cilin ballafaqohet Kosova si pasojë e emigrimit të shtetasve të saj është pamundësia e institucioneve që të merren me fluksin e ri-pranimit të personave të kthyer nga vendet e BE-së dhe ri-integrimi i tyre në shoqëri. Po ashtu duke marrë parasysh të dhënat nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës pjesa dërmuese e personave që emigrojnë nga Kosova janë të moshës së re të aftë për punë, Kosova rrezikon që në të ardhmen të humbasë fuqinë punëtore. Megjithatë duke marrë parasysh diasporën e gjerë të Kosovës dhe lidhjet e ngushta familjare që mbajnë emigrantët me familjet e tyre në Kosovë, llogaritet që në baza

⁹ Në të kaluarën për një person që të migrojë për në vendet e BE-së përmes rrugëve ilegale kanë paguar kontrabanduesve shuma të mëdha të parash deri në 3,000 Euro, ndërsa gjatë kësaj periudhe ka patur raste kur e tërë familja ka arritur që të udhëtojë për në vendet e BE-së për një shumë më të vogël se 1,000 Euro.

vjetore Kosova pranon rreth 500 milion Euro, duke përkrahur në masë të madhe zhvillimin ekonomik të vendit¹⁰.

Republika e Kosovës përveç dukurisë së migrimit të popullatës së saj ballafaqohet edhe me sfida tjera, si pasojë e shfrytëzimit të territorit të saj nga shtetasit e vendeve të lindjes së mesme dhe Afrikës të cilët synojnë të migrojnë në vendet e BE-së. Megjithatë në bazë të statistikave nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të MPB-së, ky numër nuk është i lartë dhe për momentin nuk paraqet ndonjë kërcënim të dukshëm. Numri i personave të cilët kanë kërkuar azil në Kosovë që nga viti 2013 deri në Shtator të vitit 2015 është gjithsejtë 211 persona, shumica e të cilëve shtetas nga Siria.

Shteti	Viti 2013	Viti 2014	Jan - Sht 2015	Total
Siri	24	79	43	146
Pakistan	12	1	0	13
Irak	0	7	6	13
Tjera	26	8	5	39
Total	62	95	54	211

Tabela 9- Kërkesat për Azil në Republikën e Kosovës 2013 - Shtator 2015

Duke marrë parasysh fluksin e madh të refugjatëve nga vendet e lindjes së mesme, kryesisht të atyre nga Siria dhe Iraku, me të cilin janë duke u ballafaquar vendet e rajonit, si Maqedonia, Serbia etj, si dhe vendimet për bllokimin e pikë kalimeve kufitare, veçanërisht të kufirit Serbi - Hungari dhe atij Serbi - Kroaci, ekziston rreziku që në një të ardhme të afërt kriza e refugjatëve të bartet edhe në Kosovë dhe Shqipëri, si rrugë alternative e refugjatëve që synojnë vendet e BE-së.

KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE

Grupet e organizuara kriminale, të cilat duke u gjendur përballë kërkesës së qytetarëve të Kosovës për migrim dhe profitit që mund të sjell kontrabandimi me migrant, kanë shtuar aktivitetet e tyre që të gjejnë rrugë të ndryshme për të bërë organizimin e kontrabandimit me migrant.

Me qëllim të parandalimit të migrimit ilegal të qytetarëve nga Kosova, veçanërisht kontrabandimit të tyre nga ana e individëve dhe grupeve të organizuara kriminale, institucionet e vendit kanë ndërmarrë masa të ndryshme, duke filluar nga hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për parandalimin e migrimit ilegal, si dhe ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit me qëllim ngritjen e efikasitetit të tyre për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

¹⁰ Të dhëna nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës.

Megjithatë gjatë viteve 2012 - 2015 Policia e Kosovës ka ndërmarrë masa të shumta për të parandaluar dhe luftuar kontrabandimin me migrant, ka arritur të arrestojë të dyshuar të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve nga Kosova dhe nga vendet tjera përfshirë këtu edhe të dyshuar nga vendet e lindjes së mesme.

	2012	2013	2014	2015
Rastet: Kontrabandimi me migrant	28	42	69	55

Tabela 10- Statistikat e rasteve të Kontrabandimit me migrant 2012-2015

Sipas tabelës së lartcekur vërehet që numri i rasteve të kontrabandimit me migrant të inicuar gjatë vitit 2015 është më i ulët se gjatë vitit 2014, megjithatë ky numër është relativisht më i lartë se sa gjatë viteve 2012 dhe 2013. Duhet potencuar gjithashtu që gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014 dhe tremujorit të parë të vitit 2015 është shënuar rritje enorme e rasteve të migrimit ilegal.

Sipas të dhënave policore, nga operacionet që janë ndërmarrë për arrestimin e personave të dyshuar për përfshirje në kontrabandimin me migrant, rezulton që te shumica e grupeve të organizuara kriminale, por edhe personave të dyshuar është gjetur sasi e konsiderueshme e armëve dhe municionit, që mund të merret si indikatorë për rrezikun që paraqesin këta individë apo këto grupe të organizuara kriminale për zbatuesit e ligjit, por edhe për shoqërinë në përgjithësi.

Duke marrë parasysh që Kosova nuk është e anëtarësuar në asnjë nga mekanizmat apo agjencionet e sigurisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, institucionet e Kosovës, veçanërisht ato të zbatimit të ligjit përballen me vështirësi në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, pasi që kontrabandimi i migrantëve nuk mund të parandalohet dhe luftohet në mënyrë efikase pa një bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me vendet e rajonit, por edhe më gjerë.

Rrugët e kontrabandimit të migrantëve



Harta 1 – Paraqet rrugët e kontrabandimit të migrantëve

Rruqa e parë – Kosovë - Serbi - Vojvodinë - Hungari

Kjo rrugë është më e shkurtra dhe më e lehta për të arritur në vendet e BE-së dhe fillon nga Kosova deri në Serbi, kryhet nga kontrabandues me shtetësi kosovare dhe serbe, është më e theksuar në kufirin lindor të Kosovës me Serbinë në rrethinat e Podujevës, Dardanës dhe Gjilanit dhe në kufirin verior të Kosovës me Serbinë në rajonet e komunave Leposaviq dhe Zubin Potok.

Kalimin nga Kosova në Serbi migrantët kosovar e bëjnë pa asnjë lloj problemi pasi ky kalim bëhet pa viza dhe vetëm me letërnjoftim por edhe liria e lëvizjes së tyre nëpër territorin e Serbisë duket të jetë e lehtë deri në Vojvodinë, në vendbanimet kufitare me Hungarinë, kryesisht në rrethinat e qytetit Suboticë.

Për dallim nga migrantët kosovar, migrantët afrikano-aziatik të cilët kalojnë transit nëpër vendin tonë, kufirin Kosovë-Serbi e kalojnë ilegalisht në këmbë të përcjellë nga kontrabanduesit kosovar por edhe rrugëtimin nëpër Serbi deri në Suboticë e bëjnë pak më të vështirë edhe pse gjithnjë janë të përcjellur nga kontrabandues serb.

Nga Vojvodina, kufiri për në Hungari bëhet kryesisht në këmbë për 40 minuta, edhe për migrantët kosovar edhe për migrantët tjerë, dhe bëhet në rrethinat e qyteteve hungareze Hogosh dhe Szeged dhe prej këtu kontrabandues tjerë merren me transportin e tyre deri në vendin e destinimit por ka raste kur migrantët edhe individualisht e marrin këtë rrugëtim.

Rruga e dytë – Kosovë - Mali i Zi - Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci - Hungari

Kjo rrugë është më pak e shfrytëzueshme për shkak se duhet kaluar nëpër kufijtë e shumë shteteve, por prapë se prapë edhe kjo rrugë mbetet me rëndësi për kontrabanduesit pasi që në të gjitha këto shtete kanë bashkëpunëtorë të cilët kujdesen për kalimin ilegal të kufijve, strehimin dhe transportin e migrantëve.

Kontrabanduesit i përcjellin migrantët nga Kosova për në Mal të Zi, afër ose përmes vendkalimit kufitar Kulla si dhe në ndonjë rast të rrallë përmes Shqipërisë në vendkalimin kufitar Hani i Hotit.

Nuk dihen saktësisht vendkalimet të cilat përdoren nga kontrabanduesit në relacionin Mali i Zi-Bosnjë Hercegovinë-Kroaci-Hungari por edhe Kroaci-Slloveni, por dihet se kontrabandues me dokumenta të rregullta dhe automjete me targa nga ndonjëri nga shtetet e BE-së i përcjellin migrantët deri në destinacionin e duhur.

Rruga e tretë – Kosovë - Maqedoni – Greqi - Itali

Këtë rrugë e shfrytëzojnë migrantë të cilët destinacion kanë kryesisht Italinë, Francën dhe Belgjikën dhe fillon nga Kosova nëpër Maqedoni ku afër Gjevgjelisë kalojnë në Greqi dhe prej këtu me traget në Itali.

Në këtë linjë, kontrabandistët i bartin migrantët me vetura private me targa të ndonjërës nga shtetet e BE-së, të pajisur me dokumente të udhëtimit të falsifikuara ose të cilat janë të rregullta por që ju ngjajnë personave të kontrabanduar.

Kjo rrugë përdoret më rrallë për kontrabandim të migrantëve, bëhet pa ecje në këmbë nëpër vija kufitare.

Mediat dhe roli i tyre

Hapësirë të madhe migrimit të qytetarëve kosovar gjatë kësaj periudhe kohore i kanë dhënë mediat, duke e pasqyruar këtë migrim në të gjitha fazat e tij prej nisjes së migrantëve, rrugëtimin e tyre, kampet e përqendrimit por edhe intervista me migrantët.

Në bazë të intervistimeve nga ana e mediave të disa personave të kthyer por edhe të disa tjerëve që janë duke qëndruar në kampet e azilit në vende të Evropës Perëndimore kuptojmë se ata janë duke përjetuar kushte tmerrësisht të rënda por edhe ka të atillë të rikthyer që thonë se prapë do të tentojnë të migrojnë.

Në anën tjetër disa media kanë nxjerrë lajme bombastike të cilat kanë lënë përshtypjen se të gjithë janë duke ikur nga Kosova duke ofruar video xhirime nga nisjet e autobusëve .

Mediat kanë publikuar se Kanadaja është duke kërkuar nga vende të ndryshme të botës njerëz me profesione dhe profile të ndryshme të cilët duan të shkojnë të jetojnë dhe punojnë në këtë vend duke aplikuar përmes të ashtuquajturit “Green Card Kanadez” .

Gjithashtu një informacion i ngjashëm është publikuar në media për Suedinë¹¹ ku përmendet se ky shtet kërkon njerëz nga e mbarë bota të profileve dhe profesioneve të ndryshme, mirëpo autoritetet suedeze shumë shpejt e kanë demantuar këtë informacion.

Edhe lidhur me shtetin e Francës janë publikuar në media informacione të ndryshme si bie fjala se autoritetet franceze Kosovën e kanë futur në mesin e vendeve të pasigurta dhe jostabile dhe se gjoja ky shtet e ka hequr Kosovën dhe qytetarët e saj nga ndalesa për kërkimin e azilit, mirëpo edhe këtë informacion shumë shpejt e demantuan autoritetet zyrtare franceze.

KONTRABANDIMI ME MALLRA

Kosova si shteti i ri është edhe njëri nga shtetet më të vogla si për nga madhësia ashtu edhe për nga ndikimi i saj ekonomik në rajon. Si shkak i mungesës së zhvillimit të brendshëm ekonomik, gjegjësisht mungesës së sektorit të prodhimit dhe industrisë, sektorë këto që nuk arrijnë t'i plotësojë as për së afërmi nevojat e konsumit të brendshëm, konsum ky i cili mbulohet kryesisht nga importet.

Në Kosovë dhe në vendet e rajonit ende ekzistojnë mundësitë e hapura për tregtinë e paligjshme dhe kontrabandën e mallrave me akcizë (alkool, kafe, cigare, derivate naftës dhe produkte farmaceutike etj), si dhe mallra të tjera të falsifikuara, për shkak të standardit të ulët ekonomik dhe fuqisë së ulët blerëse të popullsisë, e cila favorizon rritjen e tregut të zi dhe kontrabandimin e mallrave.

Kontrabanda me mallra në Kosovë dhe përreth saj paraqet një ndër format më të rrezikshme të kriminalitetit në përgjithësi dhe të krimit të organizuar në veçanti, fenomen ky i cili është shprehur në përmasa të mëdha qysh pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe të brishtë me institucione në formim e sipër, kontrabandimi i mallrave është kryer pothuajse në të gjitha zonat kufitare të Kosovës me shtetet fqinje por kontrabanda me e madhe është kryer në pjesën veriore të vendit, kufiri me Serbinë.

Kontrabandimi i mallrave shkakton pasoja të mëdha në shoqëri në shumë aspekte të jetës, sidomos në aspektin ekonomik, politik dhe në atë shëndetësor, ndërsa në anën tjetër, grupet e

¹¹ <http://www.telegrafi.com/suedia-kerkon-specialiste-ne-profesionet-me-te-kerkuara-paga-mesatare-2730-euro-ne-muaj/>

organizuara kriminale kanë përfitime të mëdha nga ky lloj i krimit, pasi që përfitojnë mjete të konsiderueshme financiare duke ju shmangur tatimit, akcizës dhe tarifave doganore.

Kontrabandimi me Mallra 2012- 2015 – rastet e iniciuara nga policia

Gjatë kësaj periudhe kohore kontrabandimi me mallra nuk është në përmasa sikurse ka qenë në periudhën e më hershme dhe ky kontrabandim është duke u zhvilluar me të gjitha shtetet fqinje me një dallim më të theksuar me Serbinë, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës.

Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me mallra në sasi të vogël por edhe me individ, mirëpo ekzistojnë shumë raste kur policia dhe doganierët janë penguar në ndjekjen e makinave me mallra të kontrabanduara nga pjesëtarë të grupeve kriminale duke ua bllokuar rrugën me automjete dhe gjësende tjera si dhe duke u vënë në ndjekje dhe kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj këtyre organeve.

Edhe informacionet e inteligjencës tregojnë të njëjtën situatë e cila na paraqitet në rastet e iniciuara nga policia dhe doganat mirëpo në këto informacione në disa raste përmenden edhe personat e korruptuar të cilët e keqpërdorin detyrën zyrtare.

	2012	2013	2014	2015
Kontrabanda me Mallra	328	259	184	182
Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore	//	177	226	250

Tabela 11- Rastet e Iniciuara nga Policia e Kosovës të regjistruara në bazën e të dhënave (SIPK) 2012 - 2015

Kontrabandimi i Mallrave sipas rajoneve kufitare, bazuar në informacionet e bazës së të dhënave nga SIPK-u

Kufiri Kosovë – Shqipëri

Nga kjo zonë kontrabandohen mallra të ndryshme duke filluar nga cigare me banderola, pa banderola, duhan i grirë, kafe, kafshë dhe ushqim i përpunuar i kafshëve, tekstil /veshmbathje, barna farmaceutike. Kontrabandimi me mallra në këtë rajon kryhet kryesisht në fshatrat e Gjakovës me kufirin me Shqipërinë afër vendkalimit kufitar Qafa e Prushit dhe në fshatin Zhub. Kontrabandimin e bëjnë individët me automjete, ndërsa në zonat e vështira kufitare kufirin e kalojnë me kuaj.

Kufiri Kosovë - Maqedoni

Sa i përket kontrabandimit me mallra këto rrugë i shfrytëzojnë kontrabanduesit të cilët destinim kanë tregun e brendshëm, nga kjo zonë kontrabandohen lloje të ndryshme të

mallrave si kafshë, veshmbathje, derivate të naftës (vaj motori), pije alkoolike, produkte ushqimore, pajisje elektrike, barna farmaceutike, cigare me banderola dhe pa banderola, duhan i grirë etj. Kontrabandistët i bartin mallrat me vetura, kurse rrugëve malore me traktor, kamion dhe me kuaj. Lokacionet të cilat i ka hasur policia janë; fshati Mjak, Gllloboqicë, Bllatë, Muqiverce, Smirë, Dimqë, Debellde, Novosellë, Dremjak, Hani i Elezit.

Kufiri Kosovë – Serbi

Kontrabanda e mallrave nga Serbia për në Kosovë ende mbetet në fokus të grupeve kriminale për shkak se produktet e këtij vendi janë mjaft prezentë në tregun e brendshëm, me çmime konkurruese. Mallrat e kontrabanduara janë kryesisht derivate të naftës, barna farmaceutike, shpezë, kafshë, produkte qumështit, fruta, produkte mishit, cigare, duhan i grirë, kafe, pije alkoolike, perime, mjete bujqësore, pajisje elektronike, tekstil. Kontrabandimi kryesor në mes të Kosovës dhe Serbisë bëhet ende në pjesën veriore të Kosovës por duke mos mbetur anash edhe rajoni i Gjilanit. Lokacionet ku bëhet kontrabandimi janë: në veri të vendit; fshati Sharpel, Serbovac, Zubin Potok, Stublina, Cerkozëz-Istog, Dumnicë e Poshtme, Llug. Ndërsa në Lindje të vendit në fshatrat; Hodonoc, Karaqevë, Rogoqicë, Breznicë. Kontrabanduesit i shfrytëzojnë mjete te ndryshme transportuese si: kamion, vetura, traktor, furgon dhe linja të rregullta të autobusëve.

Bashkëpunimi ndër institucional

Doganat e Kosovës vazhdojnë të mbesin ndër institucionet kryesore në parandalimin dhe luftimin e kontrabandës në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës dhe Agjencionin për Ushqim dhe Veterinari (AUV). Bazuar në ligjin për bashkëpunim të autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) dhe strategjinë për menaxhim të integruar të kufirit, këto tri institucione hartojnë raporte të përbashkëta të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore të vlerësimit të riskut, me qëllim të identifikimit të nivelit të rrezikshmërisë përgjatë kufinjëve të Kosovës, duke përfshirë edhe kontrabandën me mallra.

Megjithatë duke marrë parasysh strukturën dhe organizimin e doganave në nivelin qendror dhe atë lokal, qasja ndaj parandalimit dhe luftimit të kontrabandës është e decentralizuar në nivel rajonal dhe lokal, andaj edhe është tejet e vështirë që të evidentohet saktë numri i rasteve të kontrabandimit, mallrave të kontrabanduara, apo edhe vlerësimi i vlerës reale të mallrave të kontrabanduara.

Gjatë vitit 2014, vetëm njësitet Antikontrabandë kanë proceduar 181 raste të zbulimit të kundërvajtjeve si: mallra të kontrabanduara, mos deklarim i mallit, mos deklarim i saktë i mallit, mallra të ndaluara si dhe mallra të markave të mbrojtura.


Nga Hetimet e doganave të Kosovës për periudhën 2013-2015 janë ngritur gjithsej 292 kallëzime penale nën dyshimin për kontrabandë, evazion fiskal dhe krim të organizuar.

Viti	Raste tjera				Rastet e krimit të organizuar	
	Kallëzim e penale	Shmangie	Bastisje	Persona të arrestuar	Raste	Persona të arrestuar
2013	159	5,797,867.69	24	3	1	9+2 ne arrati
2014	84	7,415,065.95	14	3	1	17+5 ne arrati
2015	49	3,771,775.36	20	1	1	0
Totali:	292	16,984,709.00	58	7	3	

Tabela 12- Rastet e Kontrabandës të inicuar nga Dogana e Kosovës, për evazion fiskal dhe krim të organizuar periudha kohore 2013 - 2015

Kontrabanda me karburante dhe derivate të naftës

Sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës kontrabanda me karburante dhe derivate të naftës ka shënuar ulje të konsiderueshme nga viti në vit, ndërsa në anën tjetër sasia e karburanteve dhe derivateve të naftës ka shënuar rritje të lehtë.



Grafikoni 5 - Kontrabanda e derivateve (Nafta, Benzina, Vajra motorik/hidraulike), viti 2012 - Tetor 2015

Faktorët që kanë ndikuar në rënien e rasteve dhe sasisë së kontrabandës me derivate të naftës janë të shumtë, megjithatë ndër faktorët kryesor besohet që janë standardizimi i çmimit të derivateve të naftës me vendet e rajonit, duke ulur në masë të madhe profitin nga individët apo grupet e organizuara kriminale që ishin të përfshira në këtë aktivitet kriminal. Si faktorë tjetër besohet të jetë edhe cilësia e dobët e derivateve të naftës së kontrabanduar, çka ka ndikuar tek qytetarët e Kosovës që edhe përkundër dallimit në çmim të mos synojnë blerjen e derivateve të naftës, kualiteti dhe origjina e të cilave është e dyshimtë.

Megjithatë sa i përket derivateve të naftës mbetet sfidë fiskalizimi i pikave të shitjes, duke përfshirë edhe hezitimin e disa prej përfaqësuesve më të mëdhenj, që ndikon drejtpërdrejt edhe në konkurrencën e brendshme mes disa prej kompanive më të mëdha të naftës. Ky shqetësim është ngritur edhe nga ana e bizneseve, të cilat si kërcënim më të madh e shohin konkurrencën jo të barabartë, ndërsa trendin aktual të kontrabandës nuk e shohin si kërcënim për zhvillimin e biznesit.

Megjithatë duhet potencuar që deri më tani nuk është identifikuar ndonjë biznes i cili ka bërë ndonjë hulumtim lidhur me ndikimin që mund të ketë kontrabanda me derivate të naftës në zhvillimin e biznesit të tyre.


Kontrabanda me medikamente

Edhe pse sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës nuk është arritur që të identifikohet numri i saktë i barnave të kontrabanduara apo lloji i tyre, megjithatë në përgjithësi numri i rasteve të kontrabandës është relativisht i ulët dhe ngelet pothuajse i njëjtë që nga viti 2012.

Sipas vlerësimit të ekspertëve nga sektori privat barnat e kontrabanduara edhe pse jo në numër të madh mund të paraqesin rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, duke marrë parasysh që këto medikamente nuk i nënshtrohen asnjë lloj kontrolli mbi cilësinë e tyre, si dhe mënyra e transportit të tyre është jashtë çdo standardi të ruajtjes. Këtë vlerësim e japin edhe zyrtarët nga Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale, të cilët edhe pse nuk kanë mundur të na ofrojnë të dhëna të sakta mbi numrin e rasteve apo të sasisë së barnave të konfiskuara nga inspektorati farmaceutik për produkte dhe pajisje medicinale, janë të vetëdijshëm për rrezikun që paraqesin medikamentet e kontrabanduara për qytetarët.

Sipas vlerësimit të këtyre ekspertëve nuk janë vetëm medikamentet e kontrabanduara ato të cilat rrezikojnë shëndetin e qytetarëve, pasi që një pjesë e medikamenteve të cilat importohen në mënyrë të rregullt, nuk iu përmbahen sa duhet standardeve të ruajtjes, duke filluar nga transporti i tyre që në të shumtën e rasteve nuk bëhet në mënyrë të sigurve sipas kritereve të ruajtjes, pastaj deponimi i tyre në depo është larg çdo standardi, transporti nga këto depo deri në pikat e shitjes kryesisht bëhet me mjete të papërshtatshme transporti dhe në fund edhe ruajtja e tyre në pika të shitjes nuk bëhet sipas standardeve dhe kritereve të ruajtjes.

Si shqetësim tjetër është edhe prezenca e medikamenteve në treg pa përshkrim në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë, për të cilat pacientët shpesh herë nuk kanë njohuri mbi efektin e medikamenteve të cilat i përdorin, si pasojë e mos kuptimit të gjuhës.




Grafikoni 6 - Numri i rasteve të kontrabandimit të medikamenteve mjeksore periudha kohore 2012-tetor 2015

Kontrabanda me Cigare dhe Duhan të papërpunuar


Kontrabanda me cigare dhe duhan të papërpunuar gjatë periudhës janar-tetor 2015 ka shënuar një rritje enorme të sasisë së kontrabanduar krahasuar me tri vitet e mëhershme.

Edhe pse sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës nuk ka qenë e mundur që të jepen të dhëna të sakta lidhur me llojin e cigareve të kontrabanduara apo edhe për destinimin e duhanit të papërpunuar, megjithatë ekziston dyshimi që përveç kontrabandës, në Kosovë bëhet edhe përpunimi ilegal i duhanit dhe paketimi i tyre.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen enorme të kontrabandës me cigare dhe duhan të papërpunuar gjatë vitit 2015 vlerësohet të jetë efekti i ngritjes së çmimit të akcizës, por edhe tatimit mbi vlerën e shtuar.



Grafikoni 7- Sasia e cigareve të kontrabanduara 2012 - tetor 2015



Grafikoni 8- Sasia në kilogram e duhanit të papërpunuar, të kontrabanduar 2012 –tetor 2015

Kontrabanda e produkteve ushqimore (konsumit të përgjithshëm)

Bazuar në të dhënat nga Doganat e Kosovës dhe Agjencionit për Ushqim dhe Veterinari, si pasojë e mënyrës së ruajtjes së të dhënave, nuk ka qenë e mundur që të sigurohen të dhënat e sakta statistikore lidhur me sasinë dhe llojin e produkteve ushqimore të cilat kontrabandohen. Sipas vlerësimeve besohet që kontrabanda me produkte të mishit është më e shfaqur dhe njëherit paraqet edhe rrezik më të madh për jetën dhe shëndetin e qytetarëve të Kosovës.

Shqetësues është fakti që asnjë nga mallrat e kontrabanduara të cilat zbulohen nga Doganat e Kosovës, apo edhe nga Institucionet tjera nuk iu nënshtrohen analizave laboratorike dhe nuk jepen udhëzime dhe paralajmërime për konsumatorin lidhur me mundësinë e prezencës në treg të ndonjë artikulli të kontrabanduar që mund të paraqet rrezik për shëndetin e tyre.

Gjithashtu duke marrë parasysh që sipas legjislacionit në fuqi, Doganat e Kosovës nuk mund të ndalojnë importin e produkteve që janë në prag të skadencës së afatit të përdorimit, edhe përkundër sasisë e cila importohet, çka rrit dyshimin se këto produkte ushqimore pasi të hyjnë në Kosovë mund t'i nënshtrohen ri-paketimit dhe falsifikimit të afateve të skadencës, çka paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë për shëndetin e qytetarëve.

Mallrat të cilat shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale

Nga Dogana e Kosovës janë konfiskuar po ashtu mallra që shkelin të drejtën e pronësisë Intelektuale. Dogana e Kosovës në mbrojtje të këtyre mallrave ka arritur që në vitet 2014 dhe 2015 të konfiskojë mallra në vlerë dhe sasi prej:

- Në vitin 2014 janë konfiskuar mallra në sasi prej 221,751 copë dhe në vlerë prej 881,348.00 Euro,

- Në vitin 2015 janë konfiskuar 56,025 copë ndërsa vlera e tyre arrin shifrën prej: 934,454.00 Euro.

Mallrat që kanë qenë objekt i mashtrimeve janë kryesisht: mbathje sportive , produkte kozmetike, aksesori për telefona mobil, auto pjesë, sprej kundër korrozionit etj.

Sipas statistikave si vend burim i mallrave që shkelin pronësinë intelektuale, vazhdon të prijë Kina me 37.67%, Turqia me 20%, Dubai me 10%. Sipas llojit të mallrave vlen të theksohet, se deri më tani kryesisht gjatë importimit të tekstilit dhe logove që shkelin pronësinë intelektuale si vend burim janë mallrat nga Turqia.

Ndikimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim – MSA

Marrëveshja e MSA-së është e ndarë në tre kapituj: Kapitulli industrial, bujqësor dhe peshkataria si një lëmi i veçantë. Te kapitulli industrial ato produkte industriale që nuk janë të parapara në anekse të marrëveshjes janë me 0%. Kemi një kategori të produkteve industriale për të cilat është paraparë që pas katër viteve tatimi doganor do të jetë 0%, ky quhet lirimi i shpejtë proporcional.

Për momentin është vështirë të bëhet një vlerësim paraprak se çfarë do jetë ndikimi i MSA-së në nivelin e kontrabandës së mallrave, pasi që sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, kontrabanduesit kryesisht janë të fokusuar në artikujt për të cilët niveli i tatimit, akcizës dhe TVSH-së është më i lartë, duke iu mundësuar kontrabanduesve profit më të lartë.

KRIMET KIBERNETIKE

Shoqëria bashkëkohore sot ballafaqohet me të arriturat më të mëdha të zhvillimit tekniko-teknologjik. Ky zhvillim në shoqërinë bashkëkohore ka sjellur një numër të madh lehtësirash në njërin anë ndërsa në anën tjetër keqpërdorimi i paramenduar i këtyre të arriturave teknologjike, ka krijuar edhe një numër problemesh dhe rreziqesh, si për individët dhe grupet poashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi dhe sigurinë nacionale në veçanti.

Rritja e konsiderueshme e numrit të shfrytëzuesve të internetit në vitet e fundit në Kosovë ka sjellë me vete rrezikun e rritur të krimit dhe të sulmeve kibernetike. Disa veprimtari kriminale që kanë ndodhur janë të mjaftueshme për të theksuar dobësinë e rrjeteve kompjuterike në vend të cilat ende konsiderohen që janë në fazën e zhvillimit.

Rritja e shpejtë e krimit kibernetik ka krijuar nevojën urgjente për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit në gjithë botën me qëllim luftimin e kësaj dukurie.

Krimi kibernetik është një prej sfidave më të rëndësishme për institucionet e Republikës së Kosovës në përgjithësi, si dhe për Policinë e Kosovës në veçanti. Republika e Kosovës ka ndër marrë hapa konkret në krijimin e infrastrukturës ligjore për parandalimin dhe luftimin e të

gjitha formave të krimit kibernetik, por ende mbesin shumë sfida, sidomos në kuptimin teknik të përballjes së suksesshme me këtë formë të krimit, që në Kosovë është fenomen relativisht i ri.

Sipas të dhënave në dispozicion, shënjestra kryesore e sulmeve kibernetike në Kosovë deri më sot kanë qenë llogaritë e shfrytëzuesve, sistemi bankar, dhe ueb faqet në Internet.

Më 2013, Shoqata Kosovare për Teknologji Informative dhe Komunikimi (STIKK) botoi një studim për penetrimin dhe përdorimin e Internetit në Kosovë. Sipas këtij studimi, penetrimi i Internetit në bazë të amvisërive është 84.8%, ndërsa në bazë të përdoruesve ai është 76.6%, gjë që është shumë e afërt me mesataren e Bashkimit Evropian (BE). Për më tepër, ky studim thekson që sjelljet e shumicës së kosovarëve në hapësirën e internetit mund të krahasohen me trendet globale. Ky është një indikator mjaft i rëndësishëm për institucionet relevante të vendit tonë që të punojnë në krijimin e një ambienti të sigurt kibernetik.

Rastet e krimit kibernetik / Trendet

Duke iu referuar "Analizës së rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës", krimi kibernetik si krim jokonvencional është identifikuar si një prej rreziqeve, sfidave apo kërcënimeve globale që mund të cenojnë edhe sigurinë e Kosovës.

Krimi kibernetik përfshin veprat penale tradicionale (p.sh. mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja apo vjedhja e identitetit), veprat në lidhje me përmbajtjen (p.sh. shpërndarja në Internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore) si dhe veprat që janë unike për kompjuterë e sisteme informative (p.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit - DDoS, infektimet me viruse - malware etj.).

Krimi kibernetikë përbëhet nga vepra penale që kryhen në rrjete, me anë të rrjeteve elektronike të komunikimit dhe informimit. Ky është problem i pakufishëm, që mund të klasifikohet në tri definicione më të gjera:

- Krimet specifike të Internetit, si sulmet ndaj sistemeve informative apo fishing p.sh. faqe të rreme bankare për të marrë fjalëkalime që mundësojnë qasje në llogari bankare të viktimave.
- Mashtrime dhe falsifikime kibernetike: vjedhja e identitetit, posta e padëshiruar, klonimi i kartelave bankare dhe kartelave tjera, kodimet keqdashëse.
- Përmbajtja e paligjshme online, duke përfshirë materialet me keqpërdorim seksual të fëmijëve, nxitjen e urrejtjes racore, nxitjen e akteve terroriste dhe idealizimin e dhunës, terrorizmit, racizmit dhe ksenofobisë.

Policia e Kosovës në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve të saja për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë, ka themeluar Sektorin për Hetimin e Krimeve Kibernetike. Themelimi i këtij mekanizimi ka qenë mëse i nevojshëm, përveç tjerash, edhe për faktin se kriminaliteti po merr formë. Ky sektor është ballafaquar me një numër të konsiderueshëm të rasteve por edhe të

asistencave për stacionet apo njësitë në kuadër të Policisë. Sa i përket trendit të këtij lloji krimi, bazuar në angazhimin dhe duke iu referuar statistikave të deritanishme, vërehet se ky lloj krimi është në rritje.

Rastet që janë trajtuar nga Policia e Kosovës janë:

- Keqpërdorimi i fëmijëve përmes internetit (pornografia e fëmijëve në internet);
- Hyrje e paautorizuar në sistem kompjuterik (sulme DDoS, vjedhje e fjalëkalimeve, sulme në ueb-faqe qeveritare, të institucioneve të ndryshme publike, kompani biznesi etj.);
- Kërcënime dhe shantazhe përmes e-mail-it (përfshirë edhe ndaj personaliteteve të rëndësishme publike dhe institucioneve);
- Lajm i rrejshëm (përmes e-mail-it të falsifikuar);

Aktivitetet	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Raste nën hetime	18	24	21
Persona të arrestuar	11	7	10
Kallëzime penale	7	16	18
Grupe kriminale/shkatërruara	1	3	2

Tabela 13 - Statistikat e rasteve të krimeve kibernetike për periudhën 2013-2015

Infrastruktura ligjore

Disa nga veprat penale të cilat ndërlidhen me krimet kibernetike rregullohen me Kodin Penal të Kosovës ndërsa 8 vepra penale tjera rregullohen me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike.

Si Kodi Penal i Republikës së Kosovës e poashtu edhe Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike nuk e njohin krimin kibernetikë si një vepër penale të vetme, por janë disa vepra që hyjnë në krimet kibernetike.

Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës:

- Zbulimi i informacioneve të klasifikuara dhe mosruajtja e informacioneve të klasifikuara,
- Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike,
- Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial
- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi;
- Keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit;
- Hyrja në sistemet kompjuterike.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me masa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Budapestit për Krime Kibernetike, ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik është punuar bazuar në këtë konventë.

Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike krim kibernetik është *“një aktivitet kriminal i zhvilluar në rrjet që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së krimit, keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave kompjuterike”*.

Veprat penale sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike:

- Veprat penale kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave të sistemeve kompjuterike;
- Transferi i pa autorizuar;
- Pengimi i funksionimit të sistemeve kompjuterike;
- Prodhimi, posedimi dhe tentativa e pa autorizuar;

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2015 – 2018

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përfshirë në Programin e Qeverisë 2015-2018 hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2015 – 2018 si dhe Planin e Veprimit. Ministria e Punëve të Brendshme është ngarkuar me detyrën që të nxjerr këto dokumente dhe të implementoj ato. Për hartimin e strategjisë janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare.

Me këtë strategji parashihet të merren masa konkrete për krijimin e një hapësire kibernetike të sigurt. Institucionet relevante do të obligohen që brenda afateve të caktuara të përmbushin aktivitetet e tyre të planifikuara në planin e veprimit si dhe realizimi në vazhdimësi i detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga plani i veprimit.

Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike dhe Plani i Veprimit janë në punim e sipër. Vlerësojmë se me nxjerrjen e këtij dokumenti dhe fillimin e zbatimit të tij niveli i sigurisë kibernetike apo mbrojtja nga sulmet kibernetike do të rritet shumë.

Parandalimi dhe luftimi i krimit kibernetik në Kosovë

Sa i përket angazhimit në parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, përveç angazhimit në hetimin e rasteve, Policia e Kosovës ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e aktiviteteve të ndryshme. Këto aktivitete kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të mekanizmit të Policisë për luftimin e krimit kibernetik, vetëdijesimin e shoqërisë për siguri kibernetike, draftimin e strategjive, bashkëpunimin etj.

Disa prej aktiviteteve janë:

- Në kuadër të sigurisë kibernetike, ka pasur angazhime konkrete në shumë aktivitete që për qëllim kanë ndërtimin e kapaciteteve për siguri kibernetike. Shumica e këtyre angazhimeve janë bërë në kuadër të projektit “Ndërtimi i Sigurisë Kibernetike” të mbështetur dhe financuar nga Bashkimi Europian ku Kosova së bashku me Maqedoninë dhe Moldavinë janë shtete përfituese. Ky projekt objektiv kryesor ka mbështetjen në draftimin e strategjisë kombëtare për siguri kibernetike si dhe themelimin e CERT-it kombëtar.
- SHKK, bazuar në vendimin e Qeverisë, është angazhuar në aktivitetet e Task Forcës kundër Piraterisë dhe Falsifikimit.
- Pjesëmarrja në Forumin e Shoqatës së Bankave të Kosovës.
- Pjesëmarrës në Grupin Punues për hartimin e strategjisë kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet.
- Pjesëmarrës në një aktivitet të përbashkët mes Policisë së Kosovës dhe MASHT, i lehtësuar nga OSBE. Është përgatitur tema (vetëdijesimi për siguri në internet / ngacmimet përmes interneti) dhe është ligjërues në ASPK për mësime të cilët më pastaj njohuritë e fituara i kanë përcjellë nëpër shkollat të Komunës së Fushë Kosovës, kjo komunë ka qenë pilot-projekt.
- Përgatitja e temës për krimet kibernetike dhe ligjërimi i saj në ASPK Vushtrri për kadetët policor si dhe hetuesit.

KORRUPSIONI/ SHPËRLARJA E PARAVE

Republika e Kosovës ka bazë të mjaftueshme ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, megjithatë sipas shumë raporteve, publikimeve dhe hulumtimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare vlerësohet se edhe më tutje niveli i korrupsionit në Republikën e Kosovës mbetet ende i lartë.

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës lidhur me rastet e korrupsionit, vërehet pothuajse numër relativisht i njëjtë nga viti në vit, megjithatë gjatë vitit 2015 në krahasim me vitin 2014 shihet një ngritje e lehtë e rasteve të korrupsionit të iniciuara nga Policia e Kosovës. Numri i

rasteve dhe personave ndaj të cilëve është ngritur kallëzim penal gjatë vitit 2015 është më i ulët se sa në vitin 2013.

Niveli i raportimit dhe detektimit të rasteve të korrupsionit dhe shpëlarjes së parasë mbetet mjaft i ulët, si rezultat i mos gatishmërisë së qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve, posaçërisht duke marrë parasysh që korrupsioni nga një pjesë e shoqërisë llogaritet si e vetmja mënyrë për të përfituar beneficione.

Statistikat e veprave penale të Korrupsionit	2012	2013	2014	2015
Numri i kallëzimeve penale	139	236	96	154
Numri i personave të arrestuar	65	69	65	67

Tabela 14 – Veprat penale të korrupsionit periudha kohore 2012-2015

Deri më tani nuk është arritur të identifikohet ndonjë grup i organizuar kriminal i përfshirë në rastet e korrupsionit apo shpëlarjes së parasë

Bazuar në vlerësimet, analizat dhe hetimet, e bëra nga komponentët e ndryshme (projekte, OJQ, sondazhe, policia, etj) vendore dhe ndërkombëtare më së shumti korrupsioni është i paraqitur në institucionet publike ku ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike. Si forma më të shpeshta të paraqitjes së korrupsionit janë:

- a. Në fushën e Prokurimit Publik,
- b. Në fushën e Shëndetësisë,
- c. Në fushën e Privatizimit,
- d. Në fushën e Ofiqarisë.
- e. Në fushën e ndërtimeve,
- f. Në fushën e çështjeve pronësore (Gjykatat, zyrat katastrale),
- g. Si dhe në Agjensione tjera.

Institucionet e Republikës së Kosovës në përpjekje për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kanë krijuar një kornizë institucionale dhe ligjore për t'u ballafaquar me këtë problem. Disa ligje janë miratuar si: Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskim të dobisë pasurore e fituar me vepra penale, etj. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka hartuar dy strategji: Strategjinë kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit për vitin 2009-2011, dhe së fundi Strategjinë kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit për vitin 2013-2017, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Janë identifikuar sfida dhe vështirësi në implementimin në praktik të këtyre instrumenteve ligjore dhe dokumenteve strategjike.

Parandalimi dhe luftimi efikas i korrupsionit vazhdojnë të mbesin ndër kriteret dhe kushtet kyçe të cilat bashkësisht ndërkombëtare i ka vënë Kosovës për integrimet Evropiane.

Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën i vitit 2014 si dhe raporti i dytë i monitorimit për përmbushjen e kërkesave të BE-së për liberalizimin e vizave me Kosovën, liston një numër të kërkesave që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve dhe vullnetit politik në zbatimin e politikave për krijimin e përgjigjeve të duhura strukturore, në mënyrë që Kosova të fillojë me ofrimin e rezultateve nga përpjekjet e saj aktuale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në fushën e korrupsionit Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën 2014, thekson se edhe pse rastet e korrupsionit kanë qenë një prioritet nga ana e shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale, të dhënat për dënime ende mungojnë. Korrupsioni është vërejtur si një problem serioz, në shumë fusha, por prokurimi publik mbetet ende një shqetësim i madh për Kosovën. Shumica e buxhetit publik është shpenzuar në aktivitetet e lidhura me prokurimin publik. Pa angazhim të vërtetë të elitës politike të Kosovës që duhet të përkthejë përpjekjet e tyre në rezultatet aktuale, Kosova mbetet në fazën fillestare në luftën kundër korrupsionit. Institucionet e Kosovës duhet të forcojnë më tej bashkëpunimin e tyre ndër-institucional duke e forcuar gjyqësorin dhe duke e bërë atë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, në mënyrë që të ofrojnë rezultate efektive në luftën kundër këtij fenomeni.

Sipas këtyre raporteve vlerësohet se në përgjithësi, zbatimi i politikave dhe mekanizmave anti-korrupsion nuk kanë arritur të japin rezultate konkrete të pritshme. Edhe pse ligjet janë përmirësuar në një farë mase në lidhje me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik, rezultatet mbeten të pakta me numrin e ulët të dënimeve dhe sanksioneve të shqiptuara.

Ndër çështjet tjera që potencohen në këto raporte është edhe mungesa e transparencës në qeverisjen qendrore por edhe në qeverisjen lokale.

Megjithatë këto raporte sjellin në pah edhe disa nga të arriturat dhe përpjekjet e institucioneve të Kosovës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, siç janë miratimi dhe ndryshimi i ligjeve që ndërlidhen me trajtimin e çështjes së korrupsionit, por edhe në ngritjen e efikasitetit të institucioneve të ndjekjes.

Shpërlarja e Parasë : Kosova ngjashëm si vendet tjera te rajonit është e prekur nga fenomeni i shpërlarjes se parave, posaçërisht duke pasur parasysh ekzistimin ne mase te madhe te ekonomisë jo formale, dhe formave te tjera te aktivitetit kriminal qe posaçërisht zhvillohen ne shtetet e huaja e paratë përfundojnë në Kosove, apo anasjelltas.

Bazuar në rastet e raportuara dhe te hetuara në Policinë e Kosovës për periudhën 2014 dhe 2015 lidhur me shpërlarjen e parave si dhe në kallëzimet penale të dërguara në prokurorit kompetente, vërehen disa mënyra te kryerjes se kësaj vepre penale ku kryesisht parat e përfituara nga aktiviteti kriminal transferohen përmes llogarive bankare te personave fizik apo juridik neper disa shtete duke përdorur vende „off shore¹² dhe duke hapur biznese fiktive ne këto shtete pa realizuar kurrfarë aktiviteti biznesor.

¹² Vende në të cilat nuk kërkohet deklarim i prejardhjes së parave

Pastaj duke blerë patundshmëri apo hapur biznese te ndryshme ne shtete te ndryshme, apo duke përdorur persona te ndryshme te cilët kane te hapur biznese te regjistruara por qe nuk kane realizuara kurrfarë aktiviteti biznesor me dokumente te falsifikuara.

	2012	2013	2014	2015
Numri i Kallëzimeve penale	3	4	2	4
Numri i personave të arrestuar	7	0	0	2
Numri i dyshuarve në Kallëzimet penale	14	6	6	27

Tabela 15 - Statistikat e veprës penale Pastrim i parasë 2012-2015

Paratë e pastruara që rrjedhin nga aktiviteti kriminal kryesisht përfundojnë në:

- a) Investime ne prona te paluajtshme,
- b) ndërtimtari,
- c) hoteleri,
- d) vetura,
- e) hapjen e veprimtarive te ndryshme biznesore apo
- f) vazhdimin e bizneseve aktuale,
- g) Shpenzime jetësore etj.

Duke pasur parasysh qe ne Kosove ne mase te madhe është e shprehur ekonomia joformale atëherë mund te konkludojmë qe me se shumti paratë e shpëlara rrjedhin nga vepra penale baze e shmangies nga tatimi e qe është vepra me e shprehur, e pastaj edhe vepra tjera penale siç janë trafikimi me droge, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, prostitucion, kontrabanda, ryshfeti, etj.

Institucionet e Kosovës me gjithë vështirësitë ekzistuese janë te përkushtuara qe me te gjitha mekanizmat ligjor dhe instuticional ta luftojnë ketë dukuri negative te shoqërisë dhe për ketë arsye janë krijuar mekanizma te parandalimit dhe luftimit te veprës penale te pastrimit te parave.

Me qellim te parandalimit dhe luftimit te shpëlarjes se parasë, Kosova ka themeluar Njësinë për Inteligjence Financiare e cila monitoron, analizon dhe shpërndanë transaksionet bankare te dyshimta për pastrim te parave. Policia e Kosovës ne kuadër te DHKEK e ka krijuar Njësinë kundër Pastrimit te Parave, e cila merret ekskluzivisht me hetimin e kësaj vepre penale. Dogana e Kosovës regjistron çdo shume mbi 10 mije euro qe hyn ne Republikën e Kosovës, institucione tjera raportojnë siç parashihen me ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

KRIMINALITETI I PËRGJITHSHËM

ARMËT ILEGALE

Veprat penale: kontrabandimi me armë, mbajtja në pronësi e armëve si dhe përdorimi kundërligjor i tyre janë karakteristikë e rajonit dhe e popujve të Ballkanit, rajon ky në të cilin bën pjesë edhe Kosova. Numri i armëve në duart e popullatës kosovare llogaritet të jetë ende i madh edhe pse policia në vazhdimësi që nga paslufta e këndej ka konfiskuar numër të madh të këtyre armëve. Sipas disa hulumtimeve thuhet se në posedim të qytetarëve mund të jenë rreth 350.000¹³.

Këto armëve kryesisht janë armë të mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, ku një sasi e konsiderueshme e tyre janë gjetur në depo të braktisura ushtarake të ushtrisë Jugosllave, por edhe në shtëpi banimi të personave të cilët pas përfundimit të luftës kanë lëshuar Kosovën.

Bazuar në informacione, dukuri përafërsisht e ngjashme paraqitet edhe në shtetet tjera të rajonit të ballkanit, kjo për faktin se ky rajon ka kaluar nëpër disa luftëra, trazira dhe tranzicione. Këto rrethana kanë bërë që në duart e popullsisë ballkanase të bie numër i madh i armëve të cilat me mjeshhtëri janë duke u përdorur nga kontrabanduesit, çoftë për shitjen e tyre në rajon apo edhe nëpër vatrë e krizës nëpër disa shtete më të largëta. Gjithashtu sipas informacioneve, armët e kontrabanduara hyjnë e dalin nga Kosova përmes të gjitha vendeve fqinje dhe në të gjitha këto vende kontrabanduesit kosovar edhe blejnë edhe shesin armë. Kjo gjë ndodhë për shkak të specifikave të grupeve kontrabanduese, pra varësisht se ku ata gjejnë oferta më të mira për treg të armëve.

Kjo tregon se dukuria e kontrabandimit të armëve në rajonin e ballkanit është shumë e përhapur dhe bashkëpunimi i grupeve kriminale është shumë i madh, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin në mes kontrabanduesve shqiptarë dhe serb.

Përveç kontrabandimit të armëve nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, armët në vendin tonë kontrabandohen edhe nga Turqia, Bullgaria, Italia, Austria, Belgjika, Çekia etj. Bazuar në të dhënat policore nga hetimet e rasteve të posedimit të paautorizuar të armëve, rezultojnë që armët e prodhuara në ish Jugosllavi (revole të modelit TT dhe armë automatike AK47) janë më të shpeshtat. Ndërsa sa i përket kontrabandimit kryesisht janë hasur armë të gjuetisë, të cilat kryesisht janë me origjinë nga Turqia, si dhe revole të modifikuara EKOL, të cilat sipas informacioneve nga intelijenca dhe nga disa raste hetimore modifikohen në Bullgari.

Kontrabanduesit e armëve në të shumtën e rasteve sjellin armë sipas kërkesave që marrin nga klientët e tyre, të cilat i fusin në Kosovë përmes rrugëve tokësore nga vendet e rajonit me anë të mjeteve të ndryshme transportuese si vetura, kamion, autobus etj. Shumë herë vërehet keqpërdorim i bizneseve legale shitëse apo transportuese të cilat përveç punës legale kryejnë edhe aktivitete kriminale të shitjes së armëve dhe municionit.

¹³ Sipas një hulumtimi nga UNDP të realizuar në vitin 2012 vlerësohet se në Kosovë janë rreth 350.000 armë të vogla dhe të lehta. Në këtë shifër janë të përfshira edhe numri i armëve legale që janë në dispozicion të institucioneve të rendit

Megjithatë duhet potencuar që Kosova dhe qytetarët e saj nuk rrezikohen edhe aq shumë nga kontrabanda e armëve, si tranzit i kontrabandës së tyre për në vendet tjera.

Kërcënim për qytetarët e Kosovës, por edhe për institucionet e vendit, veçmas atyre të sigurisë vazhdojnë të jenë armët ilegale të cilat gjenden në duar të qytetarëve.

VRASJET

Krahasuar me vitet e mëhershme, periudha kohore 2012-2015 shënon numrin më të vogël të personave të vrarë në Kosovë. Por edhe vetë brenda kësaj periudhe kohore numri i personave të vrarë shkon duke rënë nga viti në vit për të shënuar numrin më të vogël të tyre në vitin 2015.

Shumica e vrasjeve në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore nuk janë të lidhura me krimin e organizuar ndërsa motivet kryesore kanë qenë për konteste pronësore, motive të ulta, përfitime personale, mosmarrëveshje, borxhe, fajde, hakmarrje etj. Vetë motivi është determinues edhe për zbulueshmërinë e vrasjeve prandaj edhe zbulueshmëria nga ana e organeve të ndjekjes është më e madhe.

Përderisa kriminaliteti në përgjithësi zhvillohet në qendrat urbane, kur kemi të bëjmë me vrasjet gjatë kësaj periudhe kohore vërehet se më shumë vrasje kanë ndodhur në zonat rurale sesa në zonat urbane dhe në bazë të përlllogaritjes del se 55% e vrasjeve kanë ndodhur në zonat rurale e 45% në zonat urbane.

Viti	2012	2013	2014	2015
Rastet "Vrasje"	55	39	35	25

Tabela 16: Të dhëna statistikore lidhur me numrin e rasteve vrasje në periudha kohore 2012-2015.

FAJDET /DETYRIMET

Fajdet dhe Detyrimet edhe përkundër asaj që vlerësohen ndër rastet më serioze me të cilat ballafaqohen kryesisht bizneset dhe shoqëria në përgjithësi, prapë se prapë numri i tyre i raportimit në polici mbetet mjaft i ulët.

	2012	2013	2014	2015
Fajde	13	23	32	25
Detyrim	58	62	52	61

Tabela 18: Statistikat e rasteve Fajde dhe Detyrim 2012-2015

Vepra penale të fajdeve në bazë të rasteve të raportuara nuk është e përhapur shumë por besohet se shumë raste mbeten të pa raportuara pasi që personat që marrin shuma të parave me fajde e bëjnë pa presion dhe në marrëveshje me personat që japin para me fajde dhe vetëm kur vijnë në pozitë që nuk janë në gjendje ta paguajnë shumën e cila rritet në mënyrë rapide nga fajde dhënësi dhe fillojnë kërcënimet, shantazhet, dhe sulmet fizike nga fajde dhënësit, atëherë detyrohen të paraqesin rastin në polici.

Në rastet kur fajde marrësi kërkon shuma të mëdha atëherë fajde dhënësi si garancion merr prona të luajtshme dhe prona të paluajtshme nga fajde marrësi që kanë vlerë për disa herë më të madhe se shuma që i ka dhënë, pastaj edhe nëse fajde dhënësi merr shumën e caktuar sipas marrëveshjes prapë se prapë e inskenojnë ndonjë vonesë që ka shkaktuar fajde marrësi në mënyrë që prapë të ngritet vlera dhe fajde marrësit ti merret edhe një pjese e garancionit.

Sipas të dhënave nga hetimet lidhur me rastet e fajdeve deri më tani nuk është identifikuar ndonjë grup i organizuar dhe strukturuar kriminal, por vetëm individ dhe grupe të vogla kriminale, të cilat aktivitetin e tyre kryesisht e bazojnë nga aspekti familjar (familje të mëdha). Duke patur parasysh natyrën e kësaj vepre penale ka indikacione që ky aktivitet kriminal është mjaft mirë i organizuar, sidomos në nivelin mjaft të ulët që vlerësohet raportimi i këtyre rasteve.

Sipas të dhënave nga inteligjenca, fajde dhënësit zakonisht përzgjedhin caqet e tyre, përkatësisht fajdemarrësit me mjaft kujdes, fillimisht duke i joshur ata kinse me kushte mjaft të favorshme, ndërsa pastaj përmes formave të ndryshme të presionit dhe detyrimit i detyrojnë fajdemarrësit, përkatësisht viktimat që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre.

Zakonisht sipas vlerësimeve nga zbatuesit e ligjit fajde dhënësit njihen si persona mjaft të fuqishëm, të cilët karakterizohen me epitet kriminal, duke shkaktuar frikë tek viktimat e tyre.

Ka mungesa të mëdha informacionesh mbi burimet e financave që kanë në dispozicion fajde dhënësit. Në raste të caktuara, siç edhe zakonisht arsyetohen fajde dhënësit para fajde marrësit, që mjetet financiare nuk janë të tyre, por që i takojnë ndonjë familje apo grupi kriminal me emër dhe përdorin emrin e tyre si formë presioni dhe detyrimi ndaj viktimës.


Detyrimi në vendin tonë, përveç si formë e ndërlidhur kryesisht me fajden, manifestohet edhe në mënyra tjera me anë të kërcënimeve, shantazheve dhe mënyra tjera nga individ dhe grupe të caktuara, ndaj personave që posedojnë ndonjë biznes si: dyqane, punëtori, restorante, fabrika, hotele, ndërmarrje dhe korporata të ndryshme, me qëllim që në dobi të tyre, rregullisht apo kohë pas kohe, të paguajnë sasi të caktuar të hollave. Këto kërkesa bëhen me qëllim që gjoja t'u ofrohet ndihmë dhe mbrojtje këtyre bizneseve nga grupet e tjera kriminale. Personat apo grupet që merren me detyrim zakonisht janë persona me karrierë kriminale, tipa agresivë, persona me biografi të dyshimtë etj.

Rastet e detyrimeve për shkak natyrës së krimit raportohen në numër të vogël në polici, raste që raportohen janë kryesisht janë raste individuale.

Ekziston një perceptim në publik që detyrimi është evident, duke dominuar kryesisht në bizneset legale në Kosovë, të cilat besohet se janë cak i detyrimeve nga individ apo grupe të caktuara.

GRABITJET

Gjatë periudhës 2012-2015 Grabitjet në Kosovë, janë të shprehura në tërë territorin e Kosovës, por më shumë në rajonin e Prishtinës. Kjo për shkak të përqendrimit më të madh të popullsisë si dhe të bizneseve, dhe ndodhin kryesisht në qendra tregtare, hotele, dyqane, kazino, bastore, barnatore, pika të karburanteve, shtëpi, rrugë, objekte bankare, dhe në lokacione tjera, ku kryesit me anë të forcës duke kanosur viktimat edhe me armë zjarri, thika, dhe mjete tjera të forta.



Grafiku 9- Në grafikun në vazhdim janë dhënë në mënyrë grafike rastet e 'Grabitjeve' sipas viteve duke përfshirë nga viti 2010 deri më 2015.

Tek grabitjet në rrugë dhe ambiente të jashtme, viteve të fundit viktimat të grabitjeve kryesisht janë gjinia femërore, por edhe personat e moshuar, të cilëve kryesisht ju grabiten çanta krahu, stoli ari dhe telefona celularë.

Sipas të dhënave nga inteligjenca nuk është hasur ndonjë grup i organizuar kriminal i përfshirë në raste të grabitjeve, edhe pse disa grupe të vogla kriminale janë shumë efikas në aktivitetin e tyre kriminal kryesisht në grabitje në institucione bankare dhe mikro financiare, objekte të lojërave të fatit dhe pikat e shitjes të shërbimeve postare.

